

Raiffeisen Bank Albania

Raport Vjetor 2015

Përmbajtje

Mesazh nga Kryetari i Këshillit Drejtues	128
Mesazh nga Drejtori i Përgjithshëm	129
Misioni	130
Perspektivat dhe Planet për vitin 2015	131
Raporti i Bordit Drejtues	134
Zhvillimet ekonomike	134
Rezultatet Financiare	135
Raporti i Segmenteve	142
Segmenti Korporatë	142
Segmenti i Bizneseve të Vogla (SE)	142
Divizioni i Produkteve Korporate dhe SE	143
Retail Banking	146
Zhvillimi i Segmenteve	146
Divizioni i Produkteve	147
Divizioni i Biznesit me Karta dhe Bankingut Elektronik	148
Kanalet e Shpërndarjes	149
Thesari dhe bankingu i Investimeve	152
Të ardhurat fikse	152
Tregu i parasë	152
Këmbimi valutor	153
Shitjet e thesarit	153
Përgjegjësia Sociale e Korporatës	156
Burimet Njerëzore dhe Trajnimet	157
Raporti i Auditorit të Pavarur	164
Raiffeisen Leasing	228
Rreth Raiffeisen Invest sh.a	232
Një vështrim mbi Raiffeisen Bank International	236
Rrjeti i Raiffeisen Bank SHA	237
Adresa dhe Kontakte	238



Antarët e Bordit Drejtues të Raiffeisen Bank Sh.a (nga e majta në të djathtë):

Alexander Zsolnai

Zëvendës Drejtor i Bordit Drejtues

Christian Canacaris

Drejtor i Përgjithshëm



John McNaughton
Anëtar Bordi për Retail

Elona Mullahi (Koçi)
Anëtar Bordi për Korporatat dhe SE

Raporti i Bordit Mbikqyrës

Zonja dhe Zotërinj,

Në fillim të vitit 2015, Raiffeisen Bank International njoftoi një rishikim të strategjisë së korporatës të cilin tregu e priti shumë pozitivisht. Theksi i vënë në tregjet në të cilat RBI mund të gjenerojë kthime të qëndrueshme si pasojë e një pozite të fortë është mirepritur, ashtu sikurse janë mirëpritur edhe veprimet e ndërmarra për të arritur këto objektiva. Plani për tu bërë një bankë universale më e fokusuar te marrëdhënie të ngushta me klientët, duke reduktuar ndërlikimet dhe riskun edhe nëpërmjet forcimit të kapitalit, është në rrugën e duhur dhe i vlerësuar nga pjesëmarrësit në treg.

Më shumë se kurrë, një bankë tashmë ka nevojë për fokus – dhe fokusi i RBI është në Europën Qëndrore dhe Lindore (EQL) dhe në Austri. Për këtë arsye, RBI-së ju desh të rishikonte të gjithë veprimtaritë që nuk lidheshin me këtë fokus, edhe në rast se këto kanë qenë shumë të suksesshme në të shkuarën. Gjatë kësaj kohe është riparë dhe rrjeti i degëve i deritanishëm në EQL. E gjithë kjo ndodhi në kuadër të kërkesave me të larta rregullatore të raportit të kapitalit, të cilat u morën në konsideratë gjatë përcaktimit të objektivit të CET1 dhe raportit total të kapitalit.

Gjatë 2015, RBI ka fuqizuar ndjeshëm bazën e saj të kapitalit, me raportin e plotë të CET1 që shënon 11.5 përqind në fund të vitit, dhe gjithashtu arriti një fitim të konsoliduar prej 379 milion Euro. Arsyja kryesore e arritjes së këtij rezultati pozitiv ishte ulja e vlerës neto të provigjioneve nga humbjet. Për më tepër, shpenzimet administrative u ulën me 4 përqind krahasuar me 2014, në kuadër të iniciativës së RBI-së për reduktimin e kostove.

Për sa i përket Raiffeisen Bank Sh.a, jam krenar të them se pavarësisht vështirësive, patën një vit të suksesshëm financiar duke regjistruar rezultate pozitive. Për më tepër, do të doja të theksoja arritjen e suksesshme të Raiffeisen Leasing Sh.a, e cila finalizoi blerjen e portofolit të Tirana Leasing dhe konsolidoi më tepër pozicionin e saj lider në tregun Shqiptar të lizingut.

Do të doja të përfitoja nga kjo mundësi për të falenderuar të gjithë punonjësit e Raiffeisen Bank në Shqipëri për punën e tyre dhe përpjekjet e vazhdueshme për t'i shërbyer klientëve tanë dhe për t'i sjellë përfitime të gjithë Grupit Raiffeisen.

Në emër të Bordit Mbikqyrës,



Helmut Breit
Kryetar i Bordit Drejtues



Mesazh nga Drejtori i Përgjithshëm

Pavarësisht mjedisit të vështirë ekonomik dhe sfidave të vitit 2015, Raiffeisen Bank Sh.a arriti një rezultat pozitiv. Falë bashkëpunimit të të gjithë segmenteve të biznesit ne arritëm objektivat tona dhe tani jemi gati për vitin 2016. Më tepër se 700,000 klientë në mbarë vendin, të cilëve u ofrojmë një gamë të gjerë produktesh kursimi, kredie dhe pagesa, kanë besim tek ne.

Edhe pse Shqipëria ka një mjedis të vështirë ekonomik, asetet totale bankare u rritën me 1.9 përqind në krahasim me një vit më parë. Raiffeisen Bank mbetet numri një në tregun e kredidhënies duke zotëruar 18.9 përqind të tregut. Në përgjigje të këtyre kushteve të vështira ne përmirësuam proceset dhe shërbimet duke e bërë bankën tonë më efçente.

Ne vazhduam fokusin tonë në përmirësimin dhe zgjerimin e gamës së shërbimeve dhe produkteve që i ofrojmë klientëve tanë gjatë vitit. Së bashku me internet dhe mobile banking, M-Pay i lejon klientët tanë të hynë në llogarinë e tyre dhe të kryejnë transaksione 24 orë në ditë në shtatë ditë të javës, kudo që ndodhen.

Për më tepër, Raiffeisen Leasing vazhdon të jetë zgjedhja e preferuar si për bizneset edhe për individët, të cilët kërkojnë financim në makineri, pajisje, makineri transporti dhe makina. Raiffeisen Leasing finalizoi marrëveshjen e blerjes dhe transferimit të portofolit të Tirana Leasing sh.a, pjesë e Pireaus Group. Kjo lëvizje ishte blerja më e rëndësishme midis kompanive të lizingut në tregun Shqiptar.



Raiffeisen Leasing është kompania lider në tregun e lizingut. Blerja e portofolit të Tirana Leasing rriti ndjeshëm peshën e Raiffeisen Leasing Sh.a në tregun Shqiptar të lizingut duke zotëruar 60 përqind të tij.

Përveç kësaj, Raiffeisen Invest është kompania numër një në tregun shqiptar që ofron treg për fondin e investimeve, e cila gjithashtu ofron për bizneset dhe individët produktin e fondit privat të pensioneve. Kjo kompani pati rezultate shumë të mira, të cilat ndikuan pozitivisht në rezultatet e Bankës.

Në vitin 2016, ka ende sfida të cilat qëndrojnë para nesh dhe ne do të duhet të punojmë shumë për të arritur objektivat tona. Megjithatë, punonjësit tanë janë të mirë trajnuar, të fokusuar dhe të vendosur që Raiffeisen Bank Sh.a të jetë zgjedhja e parë në sektorin bankar vendas.

Së fundi, në emër të bordit drejtues, do të doja të falenderoja sinqerisht të gjithë punonjësit tanë, klientët dhe bizneset partnere për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre gjatë vitit 2015 dhe unë pres që viti 2016 të jetë një tjetër vit i suksesshëm.

Christian Canacaris
Drejtor i Përgjithshëm
Kryetar i Bordit Drejtues

Misioni

Ne rrisim standartet bankare dhe bëjmë ndryshimin në jetën e konsumatorit duke ofruar produkte konkurruese dhe shërbime me cilësinë më të mirë.

Ne kërkojmë marrëdhënie afatgjata me klientët.

Si anëtare e Raiffeisen Bank International, ne bashkëpunojmë ngushtë me RBI-në dhe me antarët e tjerë të grupit.

Ne arrijmë një kthim mbi kapitalin të qendrueshëm dhe mbi mesataren.

Ne i japim mundësi punonjësve tanë të jenë sipërmarrës, të tregojnë iniciativë dhe nxisim zhvillimin e tyre.

Perspektivat dhe Planet për vitin 2016

Pas sfidave të vitit 2015, Raiffeisen Bank planifikon të vazhdojë zhvillimin e saj dhe ti ofrojë edhe më tepër ekonomisë së vendit. Konkurrenca do të vazhdojë të jetë e ashpër edhe gjatë vitit 2016. Ne do t'i përgjigjemi duke vazhduar të fokusohemi në marrëdhënie bashkëpunuese me klientët dhe duke vazhduar investimet në produkte, shërbime dhe risitë e teknologjisë.

Viti 2015 vazhdoi të ishte zgjedhja e parë bankare për më shumë se 700,000 klientë në të gjithë vendin. Cilësia e shërbimit ndaj klientit në të gjitha segmentet do vazhdojë të jetë prioritet. Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve, përmirësimi i efikasitetit, thjeshtësimi i procedurave dhe përqsja nëpërmjet kanaleve të ndryshme do të na ndihmojnë për të arritur objektivat tona. Ne kemi si qëllim të mbajmë pozicionin e bankës si banka me portofolin më të madh në vend në kredidhënie, duke vendosur theks të veçantë në rritjen e cilësisë së portofolit të kredive.

Për sa i përket segmentit korporatë, ne do të fokusohemi në projektet e suksesshme dhe do të vazhdojmë të ofrojmë gamë të gjerë shërbimesh bankare si për biznesin dhe për punonjësit e tyre. Për më tepër, shërbimet bankare digjitale do të jenë prioritet. Gjithashtu ne planifikojmë të sjellim produkte dhe shërbime të reja në treg. Në të njëjtën kohë, rrjeti i degëve do të vazhdojë të përmirësohet me vendosjen e standardeve të reja si dhe me rivendosjen e disa degëve në hapësira më të mëdha dhe më të përshtatshme. Klientët tanë janë prioriteti ynë dhe ne do të ofrojmë gjithmonë shërbimin më të mirë në vend.


Ne kaluam vështirësitë e këtij viti falë punonjësve më të mirë në tregun bankar në Shqipëri. Ne punuam dhe fituam ndaj sfidave si një skuadër. Për këtë arsye dëshirojmë të falenderojmë të gjithë punonjësit për përpjekjet dhe punën e tyre. Ne do të mbajmë këtë pozicion dhe do të përballojmë sfidat e reja edhe për vitin 2016.

Së fundmi, do të dëshironim të falenderonim sinqerisht të gjithë klientët dhe bizneset partnere për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre gjatë vitit 2015. Ne mbetemi të përkushtuar për të përmbushur kërkesat tuaja bankare, duke ju ofruar një shërbim me cilësi të lartë në çdo pikë kontakti që mund të keni me ne. Ne do të bëjmë më të mirën për të qenë gjithmonë zgjedhja juaj e parë si partner bankar

Bordi Drejtues
Raiffeisen Bank Sh.a



Christian Canacaris
Drejtor i Përgjithshëm



Alexander Zsolnai
Zëvendës Drejtor i
Bordit Drejtues



John McNaughton
Anëtar Bordi për
Biznesin Retail



Elona Mullahi (Koçi)
Anëtar Bordi për Biznesin
Korporatë dhe SE

TIRANA

Tirana është kryeqyteti i Shqipërisë që prej vitit 1920. Epiqendra sociale, kulturore dhe politike në Shqipëri.

Një gërshetim i stileve urbanistike dhe tradicionale të epokave nga më të ndryshmet dhe një destinacion turistik i pazëzueshëm.





Raporti i Bordit Drejtues

Zhvillimet Ekonomike

Ekonomia shqiptare gjatë vitit 2015 shënoi një rritje prej 2.6 përqind, më të lartën në katër vitet e fundit, por përsëri mbeti nën nivelin e potencialit të saj që llogaritet të jetë të paktën 4 përqind. Rritja ekonomike u rikuperua e mbështetur më së shumti nga rigjallërimi i sektorit të ndërtimit, nga industria dhe disa aktivitete shërbimesh. Në 2016 ekonomia pritet të përshpejtojë rritjen në rreth 3.5 përqind me mbështetjen e investimeve të huaja direkte dhe rikuperimit të kërkesës së brendshme që pritet të vijë nga përmirësimi i aktivitetit të kreditimit dhe thellimi i reformave strukturore.

Pozicioni i jashtën i vendit u përmirësua në 2015-ën duke shënuar deficietin e llogarisë rrjedhëse në nivelin e 1.15 miliard Euro ose 10.3 përqind më pak se viti i mëparshëm, që erdhi më së shumti për shkak të rezultatit pozitiv të eksportit të shërbimeve që shënuan një rritje prej 62.4 përqind nga viti në vit, ndërsa deficieti tregtar i mallrave u përkeqësua me 3.8 përqind në 2015 për shkak të uljes së eksporteve dhe të rritjes së moderuar të importeve. Remitancat ruajtën pothuajse të njëjtin nivel me vitin e kaluar me rreth 600 milion Euro, ndërsa investimet e huaja direkte u rritën me afërsisht 7.3 përqind në bazë vjetore duke arritur nivelin e 871 milion Euro-ve dhe financuan 75.4 përqind të deficietit të llogarisë rrjedhëse. Importet e mallrave dhe investimet e huaja direkte pritet të vazhdojnë rritjen në 2016 për shkak të ndërtimit të veprave të mëdhaja energjitike (TAP, hidrocentrali i Devollit) dhe investimeve në projekte të tjera në energjitikë dhe infrastrukturë. Eksportet do të mbeten të dobësuar për shkak të çmimeve të ulta të naftës dhe mineraleve, bazës jo të gjerë të produkteve të eksportit dhe ekonomive jo të fuqishme të rajonit.


Spektori publik mbylli dhe një vit tjetër të konsolidues, duke ulur deficietin buxhetor në nivelin 402.8 milion Euro ose 23.3 përqind më pak se në 2014. Raporti i deficietit buxhetor ndaj PBB-së vlerësohet të jetë reduktuar në afërsisht 3.8 përqind krahasuar me pritshmëritë prej 5.0 përqind. Të ardhurat buxhetore në 2015 u rritën me 3.9 përqind krahasuar me një vit më parë, por gjithsesi më pak se parashikimi për shkak të performancës së ulët në mbledhjen e TVSH-së, taksës së të ardhurave personale dhe taksës së akcizës, të cilat u ndikuan negativisht dhe nga ulja e madhe e çmimit të naftës dhe mineraleve. Konsolidimi i financave publike do të vazhdojë dhe në vitet e ardhshme deri sa të ulët nivelin e borxhit publik nën 60 përqind të PBB-së në 2019 nga rreth 73 përqind që arriti në 2015. Gjatë vitit 2015, ecuria e programit ekonomik të qeverisë sipas ekspertëve të FMN-së u vlerësua e pajtueshme me planin e rënë dakort në kuadër të marrëveshjes 3-vjeçare të kredisë me FMN-në. Ky vlerësim dhe angazhimi i qeverisë në konsolidimin e financave publike ndikoi në suksesin e emetimit të Eurobondit 5 vjeçar në fillim të nëntorit në shumën e 500 milion Euro me kupon 5.75 përqind dhe vlerësimin e perspektivës ekonomike nga "e qëndrueshme" në "positive" nga ana e kompanisë së vlerësimit të borxhit Standard & Poors në tetor 2015 duke premtuar një rritje të notës së borxhit sovran brenda 6 muajve të ardhshëm.

Norma mesatare e inflacionit në 2015 arriti 1.9 përqind duke qendruar poshtë nivelin të objektivit 3.0 përqind të Bankës së Shqipërisë për inflacionin ndikuar nga niveli i ulët i çmimeve të importit dhe çmimeve të naftës të cilat pritet të vijojnë edhe në 2016. Në këtë situatë pritësh të ulta të presioneve inflacioniste, Banka e Shqipërisë me synimin për të stimuluar rritjen ekonomike dhe për rikthyer inflacion në objektiv ka ndjekur një politikë monetare ekspansioniste edhe në vitin 2015 duke ulur dy herë normën bazë të interesit në muajin Janar dhe në muajin Nëntor në nivelin më të ulët historik të 1.75 përqind. Kjo politikë monetare relaksuese pritet të vazhdojë dhe në 2016.

Spektori bankar ka ruajtur ritmin zgjerues në 2015 duke rritur aktivitetin me vetëm 1.9 përqind në bazë vjetore krahasuar me rritjen 4.8 përqind një vit më parë. Aktiviteti bankar vazhdoi të financohet nga rritja e depozitave të klientëve që shënuan një rritje prej 2.6 përqind të pandikuara shumë nga kriza greke. Niveli i kreditimit shënoi një rënie prej 1.5 përqind në 2015 edhe për shkak të fshirjes së kredive të këqija nga bilanci i bankave në kuadër të ekzekutimit të masave të marra për të ulur nivelin e lartë të borxhit të keq. Si rezultat niveli i tyre arriti 18.2 përqind e totalit të kredive në fund të vitit 2015 i cili nuk ishte arritur që nga 2011. Masat për uljen e borxhit të keq pritet të vazhdojë në 2016 fokusuar në ristrukturim të tij, përmirësim të procesit të kolateralit, miratimin e ligjit të falimentit dhe reformën në sistemin gjyqësor. Veç kësaj duke patur parasysh edhe kostot e ulëta të financimit dhe likuiditetin e lartë të sistemit perspektiva për rritjen e kreditimit në 2016 mbetet pozitive. Sistemi bankar e mbylli vitin 2015 me fitim për shkak të lehtësimit të

provigionimit dhe uljes më të shpejtë të normave të depozitave të klientëve dhe jo për shkak të rritjes së kredisë. Sistemi bankar mbetet likuid dhe i mirëkapitalizuar me një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit në nivelin 15.7 përqind, mbi minimumin e kërkuar 12 përqind.


Rritja e Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (%nga viti në vit)



Rezultatet Financiare


Totali i aktiveve në fund të vitit 2015 ishte 290,458 milion Lekë (2014: 276,447 milion Lekë). Në 2015 portofoli i kredisë, përfaqësonte 35 përqind (2014: 41 përqind) të totalit të aktiveve të bankës. Investimet në letra me vlerë përfaqësojnë rreth 26 përqind të totalit të aktiveve në 2015 (2014: 34 përqind).

Struktura e Bilancit - Aktivi
(në '000 LEK)




Totali i huave dhe paradhënieve për klientët në fund të vitit 2015 ishte 114,611 milion Lekë (2014: 126,034 milion Lekë) duke përfaqësuar kështu një rënie prej 9 përqind të portofolit të kredisë gjatë këtij viti. Sektori i Korporatave përfaqëson 66 përqind të totalit të portofolit të kredisë dhe zuri vendin kryesor në këtë portofol me një tepricë kredie prej 75,722 milion Lekë (2014: 89,504 milion Lekë). Segmentet e Ndërmarrjeve të Mesme shënuan një rënie në portofolin e kredisë përkatësisht 3 përqind. U shënu një rritje në portofolin e kredisë prej 3 përqind për segmentin e ndërmarrjeve të vogla me një tepricë prej 2,008 milion Lekë (2014: 1,950 milion Lekë).

Struktura e Hua dhe Paradhënie për klientët




Në 2015 portofoli i kredisë përbëhet kryesisht nga një kombinim i paradhënies bankare prej 46 përqind (2014: 43 përqind), i kredisë afatmesme prej 19 përqind (2014: 21 përqind) dhe i kredisë afatgjatë që përfaqëson 18 përqind të totalit të portofolit të Bankës për 2015 (2014: 22 përqind).

Kredi gjatë vitit 2015 (në '000 LËK)




Totali i detyrimeve në fund të vitit 2015 ishte 260,247 milion Lekë (2014: 246,543 milion Lekë). Në 2015, pjesën më të madhe të detyrimeve e zënë depozitat e klientëve, të cilat përbëjnë rreth 95 përqind (2014: 95 përqind) të totalit të detyrimeve.

Struktura e Bilancit - Pasiv
(në '000 LEK)




Ashtu si në 2014, profili i depozitave të klientëve në 2015 tregon një tendencë të depozituesve për t’u larguar nga depozitat me afat të shkurtër maturimi. Me qëllim përfitimin nga interesat më të larta, klientët po investojnë kursimet e tyre në depozita me afat më të gjatë maturimi. Totali i depozitave të klientëve në fund të vitit 2015 është 120,299 milion Lekë (2014: 144,448 milion Lekë).

Struktura e Depozitave
(në '000 LEK)




2015 shënoi një rënie prej 59 përqind të fitimit pas taksës në krahasim me 2014 në 2,047 milion Lekë (2014: 5,039 milion Lekë) duke ndryshuar raportin e kthimit mbi kapitalin nga 17.61 përqind në 2014 në 6.24 përqind në 2015. Dividendi i deklaruar dhe i paguar në 2015 është 1,425 milion Lekë (2014: 5,484 milion Lekë).

Struktura e Kapitalit Aksioner (në '000 LEK)




E ardhura neto nga interesat u pakësuan me 12 përqind ose nga 11,197 milion Lekë në 2014, në 9,814 milion Lekë në 2015. Rënia e të ardhurës nga interesat bashkë me rritjen e totalit të aktiveve të bankës prej 5.1 përqind, ndikoi në pakësimin e kësaj të ardhure (llogaritur si raport i të ardhurës nga interesat mbi mesataren vjetore të totalit të aktiveve) duke e ulur atë me 48 pikë ose shprehur ndryshe nga 3.94 përqind në 2014 në 3.46 përqind në 2015.

Të ardhura neto (në '000 LEK)




Shpenzimet administrative në total gjatë 2015 arritën në 2,621 milion Lekë (2014: 2,208 milion Lekë). Efienca operuese e Bankës – raporti kosto/të ardhura ndryshoi nga 37.8 përqind në 50.12 përqind. Shpenzimet për stafin u rritën me 3.09 përqind ose 2,499 milion Lekë në 2015 krahasuar me 2,424 milion Lekë në 2014.

Shpenzime operative 2015 (në '000 LEK)



Fitimi & ROE (në '000,000 ALL)



DURRËSI

Durrës/ Dyrrahu është qyteti i dytë më i madh në Shqipëri. Mund të krahasohet me qytetet më të mëdha të Mesdheut të lashtë dhe mesjetar. Objekte unike kulture dhe trashëgimie historike janë Amfiteatri i Durrësit, Vila Mbretërore e Durrësit, Pusi i Tophanesë.





Raporti i Segmenteve

Segmenti Korporatë

Baza e konsumatorëve të segmentit korporatë ka mbetur në nivelet e vitit të kaluar duke patur në fokus të vazhdueshëm, shërbimin ndaj klientëve të saj. Gjatë vitit 2015 Segmenti i Korporatave ka filluar një fushatë për promovimin e produkteve bankare elektronike, duke qenë sërish pionier në futjen e standardeve të reja dhe kulturën bankare në treg. Numri i e-payments (pagesave-elektronike) është rritur me 38 përqind në krahasim me vitin 2014. Gama e gjërë e produkteve, shërbimet e personalizuar të ofruara për klientet e bankës si dhe bizneset e reja, kanë shënuar vit pas viti rritjen e biznesit dhe konsolidimin e marrëdhënieve me klientët e segmentit korporatë.

Kredidhënia në industritë strategjike dhe të synuara për zhvillimin ekonomik të vendit, ka qenë një nga prioritetet kryesore për segmentin e korporatave. Në fokus ka qenë cilësia e portofolit si një nga orientuesit kryesorë në Segmentin e Korporatave përmes një analize të kujdesshme për zbutjen e riskut të ndërmarrë. Devijimet e biznesit veçanërisht të prekur nga çmimet e “commodity” në të gjithë botën, janë monitoruar me kujdes duke propozuar zgjidhje alternative për klientët e këtij segmenti.

Orientimi kryesor i Segmentit Korporatë gjatë vitit të kaluar ishte optimizimi i përfitueshmërisë nëpërmjet diversifikimit dhe zgjerimit të produkteve të përdorura nga klientët. Në dhjetor 2015 numri mesatar i produkteve të përdorura nga klientët, arriti nivelin më të lartë krahasuar me atë të viteve paraardhëse.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar zhvillimit dhe përmirësimin të instrumentave të brendshëm për të lehtësuar dhe për të përmirësuar procesin e shitjes duke sjellë një rritje të përgjithshme të efikasitetit dhe produktivitetit. Segmenti i korporatave ka vazhduar të promovojë dhe të nxisë transaksione financiare tregtare, që mbarin rreziqe të ulta, të shoqëruara me kthime të larta, duke rezultuar në një rritje prej 38 përqind në krahasim me vitin 2014.

Pavarësisht rënies së normave të interesit gjatë vitit 2015, e ndikuar nga kushtet e tregut, Segmenti i Korporatave ka arritur të rrisë me 12.3 përqind volumnin e balancave të llogarive rrjedhëse, llogarive të kursimit dhe depozitave me afat. Në këndvështrimin e segmentimit të klientëve, Divizioni i Korporatave është i përbërë nga:

- Klientët Korporatë vëndase
- Klientët korporatë ndërkombëtare të cilët aktualisht operojnë në tregun vendas ose që shfaqin interes drejt tij në të ardhmen
- Institucionet Publike dhe Intitucionet Qeveritare Qëndrore dhe Lokale
- Institucione Financiare Jo-Banka

Sektori Publik

Banka Raiffeisen, si partneri kryesor financiar i Qeverisë Shqiptare, mban një peshë të rëndësishme në mbështetjen e projekteve publike nëpërmjet strategjive specifike, ofrimin e zgjidhjeve të dedikuara për produktet dhe shërbimet bankare si dhe sistemeve të komunikimit në përputhje me kërkesat specifike të këtij sektori. Ky bashkëpunim ka kontribuar në përmirësimin vit pas viti të proceseve për një përdorim më transparent dhe eficient të fondeve publike si dhe ka lehtësuar komunikimin midis bankës dhe institucioneve.

Departamenti i Institucioneve Publike, Qëndrore dhe Lokale në bankën Raiffeisen kujdeset për krijimin e një klime pozitive dhe të favorshme me të gjitha Institucionet Publike, duke forcuar edhe më tej bashkëpunimin afatgjatë.

Segmenti i Biznesit të Vogël (SE)

Raiffeisen Bank vlerëson që biznesi SE luan një rol vendimtar në rritjen ekonomike të Shqipërisë. Në këtë këndvështrim, fokusi i bankës gjatë vitit 2015 ka qenë rritja e prezencës në këtë segment biznesi duke synuar rritjen e numrit të klientëve dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të biznesit me klientët ekzistues. Sipas të dhënave të Dhjetor 2015, Raiffeisen Bank ka privilegjin t’iu shërbejë 3,491 klientëve SE në të gjithë territorin e Shqipërisë. Suksesi në këtë segment

është i lidhur me përjasjen e dedikuar dhe të specializuar kundrejt klientëve, duke ofruar produkte dhe shërbime të një niveli të lartë dhe duke siguruar kështu një partneritet të ngushtë e me perspektivë për të zgjatur në kohë.

Një kujdes i veçantë i është kushtuar rritjes së gamës së produkteve të përdorura nga klientët si dhe promovimit të Instrumentave të Financave Tregtare. Për vitin e dytë rradhazi përfitueshmeria e gjeneruar nga këto produkte ka tejkaluar me vlera të konsiderueshme buxhetin.

Monitorimi i vazhdueshëm i performancës së klientëve dhe reagimi në kohë, duke propozuar zgjedhje alternative për klientët që hasin vështirësi në biznesin e tyre, ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së portofolit të kredive.

Gjatë vitit 2015, Raiffeisen Bank ka eksploruar dhe oportunitetet e ofruara nga sektori i Agro-Bujqësisë. Divizioni i Biznesit SE i Raiffeisen Bank synon të rrisë më tej prezencën e tij në këtë sektor gjatë vitit në vazhdim. Faktori vendimtar që ka mundësuar suksesin në përmirësimin e efikasitetit, ka qenë bashkëpunimi i ngushtë mes forcës shitëse dhe manaxherëve të produkteve, me qëllim ofrimin e zgjidhjes më të mirë e më të përshtatshme financiare për klientin, si dhe gjenerimi i përfitueshmërisë optimale nga produktet e ofruara.

Divizioni i Produkteve Korporatë dhe SE

Produktet e Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër

Njësia e Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër, përmes një stafi të specializuar, ofron shërbimin e këshillimit të klientëve të saj lidhur me përdorimin e duhur të transaksioneve të Financave Tregtare si Garancitë Bankare, Letër Kreditë dhe Dokumentat për arkëtim, duke i ndihmuar klientët të reduktojnë riskun e marrëdhënieve tregtare me partnerët respektivë ndërkombëtar dhe vendas.

Raiffeisen Bank i mbështet klientët e saj në realizimin e këtyre transaksioneve në kohë dhe me cilësi. Banka ka ekspertizën e duhur teknike dhe luan një rol të rëndësishëm në edukimin e klientëve në lidhje me avantazhet e përdorimit të Produkteve të Financave Tregtare. Puna e Njësise së Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër në bashkëpunim me forcën shitëse ka kontribuar në mbajtjen e një niveli të lartë të volumeve të realizuara në këtë fushë edhe për vitin 2015. Kjo njësi ka dhënë një kontribut të konsiderueshëm në lidhje me rritjen e nivelit të njohjes dhe përdorimit të këtyre produkteve edhe tek klientët e segmentit SE krahas segmentit Korporatë.

Njësia e Produkteve të Financave Tregtare dhe Financimit Afatshkurtër mbështet gjithashtu klientët korporatë të bankës në njohjen dhe konsiderimin e produktit të Faktoringut si një mundësi alternative për financimin dhe menaxhimin më efektiv të nevojave të tyre për likuiditet. Në fushën e Financave Tregtare, banka ka ruajtur edhe gjatë vitit 2015 avantazhin konkurrues që ka krijuar në krahasim me bankat dhe institucionet e tjera financiare në vend, duke pasur një nivel të lartë specializimi, i cili përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme me mbështetjen e RBI-së në Vjenë, bashkëpunimin e vazhdueshëm me bankat e rrjetit si dhe duke shfrytëzuar strukturat e saj të balancuara dhe kanalet e gjëra të shpërndarjes.

Njësia e Financimit të Projekteve

Njësia e Financimit të Projekteve është e angazhuar në vlerësimin e nevojave të financimit dhe në ofrimin e shërbimeve financiare për Projekte Industriale dhe Pasuri të Paluajtshme sikurse transaksione të strukturuar të financimeve afatgjata që lidhen me blerje asetesh apo përthithje kompanish. Raiffeisen Bank është vazhdimisht e përqëndruar në rritjen e bashkëpunimit me klientët e saj të cilët në këtë mënyrë gjejnë një partner të denjë për të ofruar produkte dhe shërbime specifike duke respektuar praktikat më të mira të tregut. Eksperiencia dhe aftësitë profesionale gjatë bashkëpunimeve e rendisin Raiffeisen Bank si një partner të denjë të institucioneve ndërkombëtare financiare, duke i besuar një rol aktiv në financimet e strukturuar kombëtare dhe ndërkombëtare.

Duke pasur në fokusin nevojat financiare të klientëve, Njësia është e angazhuar të vlerësojë aspektin teknik, ligjor dhe strukturën financiare të çdo projekti, sikurse dhe të monitorojë performancën e tyre, prej fazës fillestare deri në përfundim të tij. Të dedikuar në përfundimin me sukses të çdo projekti dhe duke ofruar fleksibilitet në financim, në përputhje me dinamikën e tregut, cilësitë kryesore të cilat e dallojnë Raiffeisen Bank janë: kreativiteti, kompetenca si dhe njohja e mirë e tregut.

Produktet e Manaxhimit të Likuiditeteve

Viti 2015 ka qenë një vit shumë sfidues për Njësinë e Manaxhimit të Likuiditeteve. Njësia e produkteve ka qenë e fokusuar në ofrimin e një game të plotë të shërbimeve bankare, duke përfshirë manaxhimin e parave (cash) dhe likuiditeteve, shërbimet tregtare dhe zgjidhjet për produktet e thesarit. Një pikë tjetër kyçe gjatë vitit 2015 ishte mirëmbajtja dhe përmirësimi i produkteve dhe shërbimeve ekzistuese të Manaxhimit të Likuiditeteve për Korporatat dhe Bizneset e Vogla, qofshin këto kompani vendase apo ndërkombëtare.

Gjatë këtij viti, Raiffeisen ka vazhduar të jetë një partner strategjik për klientët e bankës dhe u ka ofruar shërbime sipas kërkesave specifike të tyre, në mënyrë që bizneset të optimizojnë kryerjen e pagesave të tyre dhe të përmirësoj manaxhimin e parave.

Vlejnë për tu përmendur zhvillimet e mëposhtme:

- Kanalizimi i transaksioneve bankare në rrugë elektronike (përmes Multicash), duke ofruar komisione të reduktuara për pagesat e bizneseve. Ky shërbim ofron fleksibilitet për bizneset duke shmangur rradhët në degë dhe duke optimizuar financat e tyre përmes reduktimit të kostove të transaksioneve.
- Bandat e reja të transaksioneve cash për bizneset Korporate dhe SE. Jane strukturuar kushtet e punës mbi limitet e transaksioneve Cash me qëllim monitorimin e cash-it dhe organizimin më të mirë të degëve të bankës për shpërndarjen e fondeve bazuar në kërkesat e klientëve .

Zhvillimi i Biznesit Korporatë dhe Bizneseve të Vogla

Objektivi kryesor gjatë vitit 2015 i Njësisë së Zhvillimit të Biznesit Korporatë dhe Bizneseve të Vogla ka qenë përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe rritja e efikasitetit të proceseve për Korporatat dhe Bizneset e Vogla, duke vendosur punonjës të dedikuar për biznesin në degët kryesore të Raiffeisen Bank.

Me qëllim për t'u garantuar klientëve një shërbim profesional dhe në lartësinë e duhur, trajnime dhe këshillime të vazhdueshme janë ndërmarrë nga kjo njësi. Gjithashtu në kuadër të procesimit të shpejtë dhe ofrimit të shërbimeve sa më cilësore, proceset e brendshme janë rishikuar për të qenë sa më të thjeshta dhe eficiente.

Gjithashtu, "zëri i klientit" është në vëmendje të vazhdueshme duke dëgjuar dhe administruar me përkushtim, çdo ankesë të mbërritur nga klientët e bankës. Ky proces ka një vlerë të shtuar, pasi jo vetëm ndihmon në ofrimin e zgjidhjeve për problematikat e hasura nga klientët por njëkohësisht ndihmon në përmirësimin e shërbimeve dhe proceseve të bankës në të ardhmen.

VLORA

Vlora/ Aulona është një qytet bregdetar në jugperëndim të Shqipërisë, kryeqyteti i parë i Shqipërisë së pavarur. Qendër e rëndësishme turistike, falë edhe mjedisit të këndshëm bregdetar dhe klimës tipike mesdhetare.



Retail Banking

Zhvillimi i Segmenteve të Klientëve

Segmenti i Klientëve Individë

Përfaqësja gjithëpërfshirëse e klientëve ka vijuar edhe këtë vit duke forcuar marrëdhënien dhe duke rritur aktivitetin e tyre me bankën. Raiffeisen Bank ka rritur bazën e klienteve paga me 12 përqind vit-me-vit kryesisht për shkak të formalizimit të mëtejshëm të të sektorit privat të ekonomisë. Ka arritur të rrisë peshën e klientëve paga edhe në sektorin publik me 4 përqind edhe pse në një mjedis sfidues dhe me konkurrencë të lartë. Këta klientë të cilësisë së parë kanë rritur aktivitetin e tyre kreditues dhe fokusi i bankës ka qenë në ofrimin e produkteve të përballueshme dhe me kushte fleksibël për ta. Mbështetur nga fushata të vazhdueshme promovuese, volumet e reja të kredisë personale janë rritur me 25 përqind vit-me-vit ; viti më i mirë ky që prej 2009.

Klientët Individë kanë rritur aktivitetin e tyre ditore me bankën dhe kjo ndihmoi që të rriteshin të ardhurat nga tarifat dhe komisionet me 14 përqind duke arritur një raport komisione/të ardhura prej 16 përqind. Raiffeisen Bank ka arritur të përfundojë me sukses implementimin e platformës CRM (Manaxhimi i Marrëdhënieve me Klientin) e cila i lejon të rrisi mundësitë për të arritur më shumë klientë dhe në mënyra më efektive. Gjatë vitit 2015, është rritur numri i fushatave me 2.5 herë që rezultoi në kontaktimin e klientëve me mesazhe të personalizuar.

Segmenti Premium

Banka Raiffeisen udhëheq tregun bankar në shërbim të avancuar të klientëve më të mirë që prej fillimit të segmentit Premium, në vitin 2010. Aktualisht ka mbi 13,350 klientë në segmentin Premium me kërkesa të ndryshme bankare, duke filluar nga kërkesat primare e deri tek kërkesat më komplekse, të cilat kërkojnë këshillim të plotë financiar. Janë dy nivele në Premium Banking:

- klientët Classic, të cilët marrin një shërbim të veçantë nga personel me shumë eksperiencë në degë dhe
- klientët Club i cili është kanali i shërbimit më i veçantë dhe më i specializuar, i cili i ofrohet klientëve me të ardhura tepër të larta.

Klientët Premium Club shërbehen në zona private në degë nga Menaxherët e Dedikuar Premium. Menaxherët e Dedikuar Premium janë të lokalizuar në 16 degë në qytetet më të mëdha të vendit dhe ata jo vetëm që ofrojnë një shërbim të personalizuar, por janë të trajnuar edhe në këshillimin financiar.

Strategjia e segmentit Premium është që të rritet më tepër në kredidhënie dhe në transaksione duke kontribuar në rritjen e të ardhurave në biznesin Retail. Për 2015, segmenti Premium u rrit me plus 33 përqind krahasuar me një vit më parë. Segmenti Premium është i përkushtuar për të ofruar nivelet më të larta të menaxhimit dhe shërbimit të klientëve Premium.

Segmenti i Bizneseve Mikro


Raiffeisen Bank Shqipëri gëzon tashmë një eksperiencë shtatë vjeçare në biznesin Mikro, duke ofruar një linjë të plotë shërbimesh profesionale për këtë segment. Fokusi i saj ka qenë në tërheqjen e klientëve të rinj nëpërmjet programeve të veçanta duke u ofruar klientëve Mikro një linjë prej 3 paketa shërbimesh përmes të cilave klientët mund të zgjedhin atë që i përshtatet më shumë nevojave të tyre.

Vlera që banka propozon është një kombinim i produkteve konkurruese dhe shërbimi të dedikuar, duke ofruar një partneritet solid dhe shërbim të dedikuar konsulence mbi nevojat e menjëhershme ose të ardhshme të bizneseve Mikro, duke ruajtur gjithnjë standarte të larta të shërbimit. Banka vazhdojnë të investojë në zhvillimin e fociës shitëse të dedikuar në ofrimin e shërbimeve bankare për këtë segment klientësh, të cilët janë shpërndarë në 23 degë të qyteteve më të mëdha në Shqipëri.

Viti 2015 rezultoi me përafërsisht 6,500 klientë të rinj, të cilët mundësuan ruajtjen e bazës të klientëve aktivë në 19,000 klientë. Portofoli i Aseteve të Segmentit Mikro deri në fund të vitit 2015 ishte 11 milion Euro, ndërkohë që portofoli i Pasiveve arriti 41.8 milion Euro. Portofoli i Pasiveve u rrit me 82 përqind në dy vitet e fundit si rezultat i tërheqjes dhe aktivizimit të klientëve të rinj. Gjatë vitit 2016, segmenti i biznesit Mikro do të vazhdojë të fokusohet në rritjen e

pjesëmarrjes në treg nëpërmjet tërheqjes së klientëve të rinj aktivë, rritjes së marrdhënieve me klientët primarë dhe ofrimit të marrëdhënieve të cilësisë së lartë sa i përket kreditimit të bizneseve.

Volum i Aktiveve, Pasiveve dhe Numri i Klientëve
Janar - Dhjetor 2015



Divizioni i Produkteve

Depozitat me Afat dhe Produktet e Kursimit

Gjatë vitit 2015 depozitat e klienteve individë vazhuan të zinin zërin kryesor në bilancin e bankës. Normat e tregut shënuan nivelin më të ulët në 2015, për shkak edhe të likuiditetit të tepërt në sistemin bankar. Si rrjedhojë, normat e interes për depozitat me afat u ulën në mënyrë të ndjeshme. Raiffeisen Bank ju ofron klientëve të saj mundësi alternative për mënyrën e manaxhimit dhe investimit të pasurisë, nëpërmjet kompanisë bijë të saj Raiffeisen Invest, e vetmja kompani në Shqipëri e cila ofron mundësinë e investimit të fondeve për publikun. Pjesa më e madhe e klientëve të bankës ka vazhduar të besojë në Raiffeisen Bank duke i mbajtur depozitat e tyre me afat pranë saj, pavarësisht normave të ulëta të interesit që ofrojnë. Një pjesë e mirë e klientëve ka zgjedhur të investojnë kursimet e tyre në fondet e ofruara nga Raiffeisen Invest, duke përfutur kështu të ardhura vjetore të mira, më të larta se depozitat me afat të ofruara në treg.

Fondet e Investimit të Raiffeisen Invest, të cilat ofrohen në të gjithë rrjetin e degëve Raiffeisen, kanë tërhequr gjithashtu klientë të rinj si dhe forma të tjera të investimit. Kombinimi i produkteve tradicionale të kursimit në Raiffeisen Bank me fondet e ofruara nga Raiffeisen Invest, i jep klientëve individë më tepër mundësi zgjedhjeje për të rritur të ardhurat e tyre.

Kreditë për individë

Gjatë vitit 2015 Raiffeisen Bank i ka vënë fokus produkteve të kredive personale dhe atyre hipotekare duke dalë gjatë gjithë vitit me fushata promovionale dhe oferta me kushte shumë të mira. Qëllimi i këtyre fushatave dhe ofertave është përmbushja sa më mirë e nevojave të klientëve duke i ofruar atyre mundësinë e zgjedhjes së produktit që u përshtatet dhe duke krijuar dukshëm një avantazh konkurrues në treg duke ndikuar pozitivisht në facilitimin e procesit të kredidhënies.

Rezultatet e arritura janë shumë të mira duke e renditur këtë vit si viti më i mirë i gjenerimit të kredive personale dhe atyre hipotekare që nga viti 2011. Gjithashtu gjatë vitit 2015 i është kushtuar rëndësi edhe formalizimit të nevojës për transparencë për klientët. Në këtë kuadër, një rol të rëndësishëm ka luajtur dhe Banka e Shqipërisë me lëshimin për zbatim të rregullores për Kreditë Personale dhe Hipotekare. Raiffeisen Bank duke konsideruar primare përmbushjen e nevojave të klientit, ka marrë angazhimin dhe ka arritur të implementojë kërkesat e institucioneve rregullatore brenda afatit.

Raiffeisen Bank ka ndërmarrë gjithashtu një sërë iniciativash lidhur me automatizimin e proceseve të caktuara duke synuar në lehtësimin e procesit të aplikimit për kredi nga ana e klientëve. Këto iniciativa do të ndikojnë në rritjen e efikasitetit si dhe në krijimin e një lidhjeje më të ngushtë ndërmjet bankës dhe klientëve të saj.

Divizioni i Biznesit me Karta dhe Bankingut Elektronik

Biznesi i Kartave

Biznesi i Kartave të Kredtit në Raiffeisen Bank gjatë vitit 2015 ka vazhduar të zhvillohet, duke treguar një rritje të konsiderueshme për vlerat e veprimeve të kryera përmes dy tipeve të kartave MasterCard Standard dhe MasterCard Gold. Rritja e përdorimit të këtyre kartave ka vazhduar të mbetet pozitive, si rrjedhojë e rezultateve të suksesshme gjatë fushatës "Cash Back", të zhvilluar gjatë mesit të vitit 2015.

Përgjatë vitit 2015 Raiffeisen Bank ka vazhduar të mbajë një pozicion të qëndrueshëm në treg përsa i përket Kartave të Debitit. Numri i veprimeve të kryera me këto karta në terminale ATM dhe POS është rritur me 5 përqind.

Gjatë këtij viti është punuar për të paraqitur standartin më të avancuar të sigurisë së pagesave në kartë debiti dhe kartë krediti, "3-D Secure Technology", i cili do të ndihmojë në rritjen e mëtejshme të përdorimit të kartave në blerjet në internet.

Rrjeti POS

Gjatë vitit 2015 Raiffeisen Bank zhvilloi rrjetin e saj POS në të gjitha qytetet. Ky shërbim i ofron të gjithë kartëmbajtësve mundësinë për të përdorur kartat e tyre të debitit dhe kreditit që mbajnë logot; Visa, Visa Electron, MasterCard dhe Maestro, për të kryer blerje në pikat e shitjeve (Point of Sale) dhe për të kryer veprime në filialet e bankës, transaksione Cash Advance. Rrjeti POS i Raiffeisen është i shtrirë në të gjithë vendin duke ofruar këtë shërbim në më shumë se 60 kategori të ndryshme tregtarësh duke përfshirë dhe hotele, agjenci udhëtimi, dyqane, restorante, pika karburantesh, hipermarkete, dhe në qendra të mëdha tregtare në të gjithë vendin.

Aktualisht banka është çertifikuar dhe ka në përdorim terminale pa kontakt, duke u bërë kështu banka e parë në vend që pranon pagesa me kartë pa nevojë kontakti në terminalin e saj.

Shërbimi i pranimit të pagesave me karta nëpërmjet internetit

Raiffeisen Bank ishte banka e parë në vend që ofroi në treg shërbimin e pagesave me karta E-commerce në vitin 2012. Përgjatë vitit 2015 ky shërbim është ofruar në tregtarë të ndryshëm duke rritur numrin e tyre, dyqane me zbritje, abonime televizive, shërbime interneti etj. Shërbimi i pranimit të pagesave me karta nëpërmjet internetit i jep mundësinë bizneseve që të kryejnë shitje të produkteve dhe shërbimeve të tyre nëpërmjet internetit. Banka mundëson këtë shërbim nëpërmjet teknologjive 3-D, teknologjia më e avancuar për pagesa të sigurta nëpërmjet internetit.

Rrjeti ATM

Gjatë vitit 2015 Raiffeisen Bank pati rrjetin më të madh të ATM-ve në treg 194 ATM, numër i konsiderueshëm krahasur me çdo bankë tjetër në vend. Llojet e kartave që banka pranon për të kryer veprime nëpërmjet ATM janë; VISA, VISA Electron, PLUS, MasterCard, Maestro dhe Cirrus pa kushtëzuar llojin e kartës ose bankës që ofron kartën. ATM-të e bankës ofrojnë mundësinë e tërheqjes së monedhës Euro në rreth 40 ATM në të gjithë vendin, duke u fokusuar kryesisht në ATM-të që ndodhen në zonat turistike, qendra tregtare ose zona kryesore të vendit. Vitin e fundit në ATM banka shtoi një funksionalitet të ri (i quajtur Dynamic Currency Converter – Konvertimi Dinamik Monetar për kartat MasterCard, Maestro dhe Cirrus), i cili i ka dhënë bankës një ndikim në rritjen e të ardhurave të gjeneruara nga ky biznes. Në vijimësi, banka është duke punuar për të shtuar funksionalitete të reja në ATM.

Bankingu Elektronik

Raiffeisen Bank vazhdon të udhëheqë inovacionin dhe transformimin e tregut shqiptar, duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh elektronike dhe duke lehtësuar për klientët aksesin dhe përdorimin e shërbimeve bankare. Shërbimi Internet dhe SMS banking u ofrua i pari në vitin 2010 si një mënyrë e sigurt dhe shumë komode për të kontrolluar llogaritë dhe kryer veprime të ndryshme bankare në çdo kohë dhe nga çdo vend. Platforma Internet Banking mundëson informacion 24 orë/ 7 ditë të javës mbi gjendjet dhe historikun e veprimeve në llogaritë bankare si edhe kryerjen e transaksioneve dhe pagesave të ndryshme.

I ofruar vetëm një vit më pas, shërbimi Mobile Banking prezantoi një mënyrë krejt të re bankingu, nëpërmjet përdorimit të telefonit celular, i cili ju mundëson klientëve kontrollin e llogarive, depozitave, kartave, kredive ose pagesa të ndryshme në çdo kohë.

MPAY u shtua në vitin 2013 si një shërbim i ri pagese me celular që ju ofron klientëve mundësinë që të paguajnë faturat e tyre utilitare ose të rimbushin numrin e tyre celular, në çdo kohë, vetëm duke përdorur pajisjen e tyre celulare; ky është

një shërbim pagesash utilitare shumë i thjeshtë dhe i përdorshëm nga të gjithë klientët individë, pasi nuk kërkon aparate të sofistikuar apo akses në internet. Gjatë 2016, Raiffeisen Bank parashikon të kryejë përmirësimin e shërbimeve elektronike ekzistuese për klientët individë dhe biznes, duke i transferuar ato në një platformë unike. Kanalet elektronike kanë patur një rritje të dukshme gjatë vitit 2015 në numër klientësh dhe përdorim; numri i klientëve që disponojnë të paktën një shërbim elektronik ka arritur në 73,000.

Pagesat dhe Transfertat

Numri i pagesave dhe transfertave të kryera nga individët, personat e rëndësishëm dhe klientët mikro ka patur rritje 21 përqind gjatë 2015 duke e krahasuar me vitin paraardhës, ndërsa komisionet e përfituara nga këto shërbime janë rritur me 21 përqind. Strategjia për formalizimin e ekonomisë e implementuar nga qeveria gjatë 2015, ka ndihmuar në rritjen e numrit dhe të ardhurave nga komisionet e transfertave të brendshme dhe në hyrje të performuara nga segmenti Mikro. Sasia e parave që emigrantët transferojnë në Shqipëri ka vazhduar të reduktohet edhe gjatë këtij viti. Pagesat dhe kanalet Elektronike vazhdojnë të përfaqësojnë një mundësi rritje të rëndësishme për Raiffeisen Bank.


Kanalet e Shpërndarjes

Gjatë vitit 2015 Divizioni i Kanaleve të Shpërndarjes vijoi me strategjinë e vitit 2014 për përmirësimin e efikasitetit të Rrjetit të Degëve, rritjes së nivelit të komoditetit të klientëve duke vazhduar investimet në ambientet e degëve dhe zhvillimin e kanaleve alternative dhe elektronike të shpërndarjes. Rrjeti i degëve mbetet prej kohësh me diferencë nga konkurrenca, më i madhi në Shqipëri, me 89 pika që shërbejnë në pothuajse të gjithë gjeografinë e vendit.

Eksperiencia e Klientit, mbetet në pararojë të vlerave të bankës. Komiteti Drejtues i Eksperiencës ndaj Klientit, mbikqyri zbatimin e shumë masave të ndërmarra në degë, që përmirësojnë procesin në mënyrë të atillë që të rritet koha që stafi i shërben direkt klientit. Objektivi final i bankës është që ta bëjë shërbimin ndaj klientit, avantazhin e saj konkurrues.

Në lidhje me segmentin Mikro, banka ka mbajtur një cilësi të mire të portofolit të kredive duke rritur ndërkohë bazën e saj të klientëve me mbi 6,400 llogari, rritja më e mire vjetore. Modeli i biznesit është rishikuar për të përmirësuar efikasitetin në ofrimin e kredive ndaj klientëve. Zhvillimi i kanaleve alternative ishte në fokus gjatë 2015-ës. Banka e zgjeroi rrjetin e saj të Shitjeve Direkte me 50 përqind. Si Agjentët e Shitjeve Direkte ashtu edhe Përfaqësuesit e Kredisë së Menjëhershme dhanë rezultate rekord në 2015 dhe planet e ardhshme janë në lëvizje për të rritur më tej kontributin e këtyre kanaleve kyçe. Ata mbeten të dedikuar në mbështetjen e rrjetit të degëve të bankës duke identifikuar, kualifikuar dhe duke para-shitur produktet dhe shërbimet kryesore, klientëve ekzistues dhe atyre të ardhshëm.

Si konkluzion, përveç sfidave të tregut të jashtëm, 2015-ta ishte një tjetër vit i qëndrueshëm për Kanalet e Shpërndarjes, të cilat mbeten plotësisht të angazhuara për të përbushur me përkushtim nevojat e klientëve.



GJIROKASTRA

Gjirokastra/ Argyrokastro është qyteti-kala i përfshirë në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s më 2005, me pllaka guri, ballkonet e drunjta dhe muret e gurta herë-herë të zbardhura me gëlqere. I famshëm për Festalet Folklorike, Muzeun Kombëtar të Armeve, Muzeun Etnografik dhe urën e Ali Pashë Tepelenës në lagjen Dunavat.



Thesari dhe Bankingu i Investimeve

Të Ardhurat Fikse

Edhe gjatë vitit 2015 portofoli i letrave me vlerë të bankës vijoi të ulej, imponuar nga kuadri rregullator i Bashkimit Evropian dhe institucionet e tjera rregullatore që kanë impaktuar aktivitetin e konsideruar me risk të lartë në lidhje me ekspozimet në obligacione dhe bono thesari. Gjithsesi vështirësive të hasura, normave të interesit në rënie dhe direktivave përkatëse edhe të rregullatorëve vendas, njësia e të ardhurave fikse arriti edhe gjatë vitit 2015 të përmbushë objektivat e saj veçanërisht për portofolin e tregtueshëm.

Struktura e portofolit krahasuar me vitet e tjera ka ndryshuar pjesërisht dhe investimet afatgjata në obligacione thesari janë ulur pak krahasuar me një vit më parë duke zënë rreth 75 përqind të volumeve totale. Në fund të muajit dhjetor 2015 portofoli i tregtueshëm dhe AFV (At Fair Value) kapën shifrën prej 167 milionë Euro. Përgjatë vitit 2015 banka pasuroi portofolin me obligacione korporatash dhe qeveritare të emetuara në Euro, në mënyrë që të alternonim investimet e bankës edhe në monedha të tjera.

Normat e interesit në ankandet e letrave me vlerë kanë pësuar një rënie të vazhdueshme që u impaktuan pjesërisht nga rënia dy herë gjatë vitit 2015 e normës bazë dhe sigurisht nga strategjia e Ministrisë së Financave në lidhje me borxhin. Këto norma kanë arritur nivelet minimale historike gjatë këtyre viteve dhe ky fakt ka bërë më sfidues manaxhimin e portofolit dhe arritjen e objektivave për njësinë e të ardhurave fikse. Gjithsesi portofoli i tregtueshëm prodhoi një rezultat pozitiv, sepse rënia e normave të interesit ndikoi në rivlerësimin pozitiv të tij.

Mund të themi që këtë vit është rritur shumëllojshmëria dhe numri i transaksioneve jo vetëm në tregun primar të letrave me vlerë, por edhe në atë sekondar duke marrë pjesë në ankandet e ndryshme që janë organizuar veçanërisht në muajt e fundit të vitit 2015. Banka ka patur si qëllim të rrisë dhe diversifikojë mundësitë dhe alternativat e investimeve për klientët e saj, duke ofruar letra me vlerë të maturimeve të ndryshme. Raiffeisen Bank është kërenare të deklaroj se është kontribuesi kryesor në tregun sekondar të bonove dhe obligacioneve të thesarit, duke i tregtuar ato në degët e saj në të gjithë vendin. Gjatë vitit 2015 volumi dhe numri i transaksioneve të obligacioneve të thesarit të tregtuara në tregun sekondar ishte shumë më i lartë se një vit më parë, rreth 50 përqind më shumë transaksione se një vit më parë.

Raiffeisen Bank vijoi të kryente aktivitetin e kujdestarit të letrave me vlerë të emetuara nga qeveria e Shqipërisë duke mundësuar investitorët e huaj dhe ata vendas të marrin pjesë në tregun e saj të letrave me vlerë. Ky shërbim si edhe të tjerë që do ofrohen në një të ardhme të afërme, janë pjesë e përpjekjeve dhe sfidave të bankës për të qenë pjesë e zhvillimit të tregut financiar vendas.

Tregu i Parasë

Njësia Tregut të Parasë, si një njësi aktive, ka dhënë kontributin e saj për të arritur objektivin e saj kryesor, fitimin e të ardhura rezervat e saj dhe për të ruajtur likuiditetin në nivele optimale në mënyrë që të përmbushen kërkesat për tërheqje të papritur të fondeve nga depozituesit. Njësia e Tregut të Parasë së Raiffeisen Bank ka dhënë kontributin e saj në zhvillimin e aktivitetit ndërbankar vendas dhe ka patur një rol kryesor në politikën monetare të Bankës Qendrore.

Njësia e Tregut të Parasë, si pjesë e rëndësishme e departamentit të Thesarit ka ndërmarrë një rol aktiv në optimizimin e objektivit të RWA (Risk Weighted Assets) të bankës për vitin 2015. Ajo ka përdorur instrumente të ndryshme në ruajtje e RWA-së në nivelin e synuar në përputhje me kërkesat e rregullores si lokale ashtu edhe në nivel grupi. Njësia ka kontribuar vazhdimisht për të ruajtur raportin e likuiditetit të vendosur nga Banka Qendrore në nivelin e kërkuar sipas rregullores së re të Bankës së Shqipërisë. Portofoli i Tregut të Parasë gjatë tërë vitit 2015 ka qenë i mirëmenaxhuar dhe është shtrirë në maturitete të ndryshme, sipas rregullores së re të Bankës Qendrore në lidhje me ekspozimin e bankës ndaj bankave të mëdha dhe duke respektuar të gjitha kufizimet në limite, gjithmonë duke përmbushur nevojat e bankës në çdo moment për likuiditet në çdo monedhë.

Portofoli i Tregut të Parasë është investuar në instrumente të cilësisë së lartë duke respektuar të gjitha kërkesat e nevojshme në përputhje me rregullat e reja të Bankës Qendrore, sikurse edhe duke respektuar të gjitha kërkesat e nevojshme në nivel grupi, në përputhje me të gjithë kërkesat e Basel III. Pavarësisht gjithë zhvillimeve dhe sfidave të tregut gjatë vitit 2015, Njësia e Tregut të Parasë ka bërë përpjekjet e saj maksimale për të menaxhuar me sukses likuiditetin afatshkurtër dhe duke gjeneruar një performancë të mirë në një mjedis sfidues të normave të interesit në rënie të vazhdueshme.

Si pjesë aktive dhe e domosdoshme e një tregu ende në zhvillim lokal, njësia e Tregut të Parasë kontribuon çdo ditë për botimet e TRIBOR/TRIBOR. Këto kuotime janë një aspekt shumë i rëndësishëm i zhvillimit të tregut lokal, pasi reflektojnë aktivitetin e saj, dhe TRIBID/TRIBOR janë gjithashtu një çështje e rëndësishme në parashikimin dhe interpretimin e situatës së tregut. Njësia e Tregut të Parasë do të vazhdojë të japë kontributin e saj, në mënyrë që të ndikojë më tej zhvillimin e tregut, instrumenteve dhe mundësive të investimeve në afat të shkurtër.

Këmbimet Valutore

Ky vit është karakterizuar nga një zhvlerësim i fortë i Euros përkundrejt Dollarit amerikan i ndikuar veçanërisht nga vendimi i Bankës Qendrore Evropiane për të zgjeruar programin e blerjes së bondeve në mënyrë që të parandalohet deflacioni si dhe forcimi i ekonomisë amerikane e cila u finalizua me rritjen e normës bazë të interesit. Raporti EUR/USD ra poshte nivelit 1.05 për herë të parë që nga viti 2013.

Viti 2015 ka qenë një vit shumë i suksesshëm për Njësinë e Këmbimeve Valutore, e cila nëpërmjet analizave të situatave të ndryshme financiare që ndikuan në tregjet ndërkombëtare dhe vendase u tregua e kujdesshme në manaxhimin e pozicionit valuator dhe riskut nga luhatshmëria e kurseve të këmbimit duke finalizuar vitin 2015 me rezultate të larta financiare. Në tregun vendas kuotimi EUR/ALL është përcaktuar nga ofertë – kërkesa e tregut dhe arriti nivelin më të ulët që prej vitit 2010, duke u kuotuar me 136.80.

Përsa i përket dollarit amerikan ai ka arritur pikën më të lartë të kuotimit gjatë vitit 2015 duke ndjekur të njëjtën luhatshmëri si në tregjet ndërkombëtare. Dollari amerikan arriti pikën më të lartë në 12 vitet e fundit, 133.35. Kriza në ekonominë evropiane dhe veçanërisht e vendeve fqinjë ka pasur ndikimin e saj edhe në tregun shqiptar duke ulur ndjeshëm aktivitetin financiar të bizneseve vendase. Njësia e Këmbimit valutor ka dhënë mbështetjen e saj maksimale në tregun lokal me mbajtjen e një kuotimi konkurrues në ofertë/kërkesën në tregun ndërbankar dhe me klientët. Volumet e transaksioneve të këmbimit valutor kanë vazhduar të jenë të larta, deri në 200 milionë Euro në muaj, ku operacionet EUR/USD përbëjnë pjesën më të madhe.

Njësia e Shitjeve

Përsa i përket tregjeve financiare, viti 2015 ishte një vit i vështirë. Kriza ekonomiko-financiare u pasqyrua edhe në tregun Shqipëtar, duke prekur ndjeshëm biznesin. Edhe pse në mes të kësaj krize, njësia e shitjeve e Thesarit, tashmë më një përvojë dhjetë vjeçare, arriti që të realizonte objektivat, dhe më e rëndësishmja për të qendruar pranë kërkesave të klientëve. Falë mbështetjes së të gjitha kanaleve të biznesit, njësia e shitjeve të Thesarit, edhe këtë vit ia arriti që të ishte lider në tregun financiar Shqipëtar duke ofruar çmimet më konkurruese në treg.





ELBASANI

Elbasan/ Skampius ndodhet në Shqipërinë e Mesme; një qendër e rëndësishme industriale dhe historike me një gamë të gjerë profesioneve të cilat ushtroheshin aty si: lëkurëpunues, metal punues/argjendarë, tregtarë dhe punues mëndafshi, këpucarë, deri tek samarxhinjtë, qeleshepunuesit dhe çibukçinjët.

Përgjegjësia Sociale e Korporatës

Raiffeisen Bank në Shqipëri mbetet e angazhuar në përgjegjësinë sociale të korporatës me synimin për të kontribuar në qëndrueshmërinë dhe përmirësimin e kushteve sociale, shëndetësore dhe mjedisore të komunitetit në Shqipëri.

Gjatë vitit 2015 Raiffeisen Bank në Shqipëri u nderua nga Bashkia e Gjirokastrës me titullin “Mirënjohja e Qytetit” për kontributin e vlefshëm në sektorë të ndryshëm si shëndeti, arsimit, kultura etj. Një tjetër vlerësim për Raiffeisen Bank në 2015 ishte edhe dhënia e “Çertifikatës së Mirënjohjes për kontributin në komunitet” akorduar nga Bashkia Lushnje në kuadër të mbështetjes së dhënë nga banka për komunitetin e këtij qyteti.

Si çdo vit edhe gjatë vitit 2015, në fokus ka qënë sektori i arsimit ku kontributi i Raiffeisen Bank ka qënë i konsiderueshëm edhe gjatë këtij viti. Në këtë kuadër, Raiffeisen Bank në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore të qyteteve Shkodër, Lezhë, Berat, Gramsh, Kucovë etj., ka mbështetur aktivitetet e organizuara nga këto institucioneve me rastin e 7 Marsit, festës së mësuesve. Kontributi i Raiffeisen Bank ka vijuar më tej në këtë sektor edhe me mbështetjen e projekteve edukative e kulturore për shkollat e mesme në Lezhe, Shkodër, Tiranë, Korçë, Vlorë, Sarandë etj.

Një tjetër sektor shumë i rëndësishëm ku Raiffeisen Bank ka dhënë kontributin e saj përgjatë vitit të kaluar është ai i shëndetësisë. Duke qënë një sektor shumë i rëndësishëm, i cili kontibuon direkt në përmirësimin e jetës së komunitetit Raiffeisen Bank ka mbështetur projektet për rikonstruksion ambjentesh apo blerje pajisjesh të nevojshme për Spitalin Fier, Spitalin Erseke, Spitalin Sarande si dhe Drejtorinë e Shëndetit Publik Pogradec, Drejtorinë e Shërbimit Shëndetësor Përmet dhe Institutin e Shëndetit Publik Lezhë.

Raiffeisen Bank ka vijuar kontributin e saj për projektet me karakter social. Një projekt i rëndësishëm ka qënë ngritja e sallës së psikomotricitetit pranë Qendrës TISS- Qendra e Shërbimeve dhe Trajtimit Psikosocial. Kjo sallë do tju vijë në ndihmë fëmijëve që trajtohen në këtë qendër, të cilët vuajnë nga çrregulimet e spektrit të autizmit. Gjithashtu po në këtë kuadër, Raiffeisen Bank ka mbështetur ngritjen e Qendrës për Trajtimin e fëmijëve të ushtarakëve që vuajnë nga çrregullimet e spektrit të Autizmit. Ky i fundit ishte një bashkëpunim me Ministrinë e Mbrojtjes. Më tej banka ka vazhduar mbështetjen e saj për Fondacionin “Down Syndrome Albania”, dhe aktivitetet e organizuara prej tij me rastin e 21 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Down.

Një projekt tjetër me karakter social, që ka gjetur mbështetjen e Raiffeisen Bank edhe këtë vit ka qënë, aktiviteti “Së bashku në një” organizuar nga Shoqata e Gjimnastikës Aerobike, në ditën ndërkombëtare të jetimëve. Kjo tashmë është kthyer në një traditë që Raiffeisen Bank mbështet prej 8 vitesh, dhe që mbledh bashkë mbi 500 fëmijë të moshave të ndryshme, që vijnë nga disa qytete të vendit, nga Shtëpitë e Fëmijës dhe nga komuniteti rom. Këtë vit realizuan një performancë të shkëlqyer edhe fëmijët e projektit të Qendrës “Don Bosko” që mbështetet nga Fondacioni “Herbert Stepic”.

Një tjetër sektor po aq i rëndësishëm është ai i mjedisit. Kështu Raiffeisen Bank ka vijuar mbështetjen e aksioneve të pastrimit të bregdetit të organizuara nga “Korpusi i vullnetarëve” dhe Forumi i Mendimit të Lirë. Në këtë kuadër u bë i mundur pastrimi i zonave të bregdetit të Velipojës, Gjiri Lalzit, Spille dhe Zvërnec. Një tjetër projekt që Raiffeisen Bank vijon të mbështesë në këtë fushë është “Eco Fashion Shoë”. Kjo është një iniciativë e një grupi vullnetarësh, që nëpërmjet organizimit të një sfilate mode ekologjike përcjellin mesazhin “Redukto - Riciklo - Ripërdor – Rikrijo”.

Raiffeisen Bank gjatë 2015 i ka dhënë një rëndësi të madhe edhe vlerave të trashëgimisë kulturore ku në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës bënë të mundur restaurimin e Kalasë së Gjirokastrës duke i shtuar vlerë më shumë këtij qyteti, i cili kremtoi 10-vjetorin e përfshirjes në listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s.

Gjithashtu edhe stafi i Raiffeisen Bank ndërmori një iniciativë të quajtur “Surprizë në kuti” në kuadër të përgjegjësisë sociale gjatë festave të fundvitit. Secili prej tyre ka paketuar një lodër për fëmijët, të cilët ndoshta nuk e kishin mundësinë të merrnin një dhuratë për Vitin e Ri. Nëpërmjet kësaj iniciative, punonjësit e Raiffeisen Bank shpërndanë mbi 300 dhurata për fëmijët në nevojë në zonën e Kombinait.

Raiffeisen Bank në Shqipëri përveç ofrimit të produkteve dhe shërbimeve bankare mbetet gjithmonë e angazhuar për të kontribuar dhe mbështetur projekte që ndihmojnë komunitetin dhe përmirësimin e jetës së tij, si pjesë e përgjegjësisë sociale të korporatës.

Burimet Njerëzore

Me një staf prej mbi 1,400 punonjës, Raiffeisen Bank është një nga punëdhënësit më të fuqishëm dhe më të mirë në Shqipëri, duke krijuar një mjedis konkurrues përsa i përket kompensimit, zhvillimit dhe motivimit të stafit.

Rekrutimi dhe Selektimi

Gjatë vitit 2015, procesi i rekrutimit dhe selektimit të stafit synoi përzgjedhjen e një stafi të kualifikuar, me eksperiencë dhe aftësi profesionale në të gjitha nivelet e shërbimit në bankë, për të mbështetur nevojat e biznesit në të gjithë fushat ku operon. Për të vlerësuar dhe përzgjedhur kandidatët më të mirë dhe profesionistët më të mirë në treg, proceset e rekrutimit kalojnë në disa faza, ato të testeve teknike, logjike dhe/ose psikometrike si edhe testet e personalitetit. Kandidatët e selektuar në këto faza bëhen pjesë e proceseve intervistuese ku paneli është i përbërë nga supervizorët e departamentit/distrikteve dhe një përfaqësues nga Divizioni i Burimeve Njerëzore.

Për Raiffeisen Bank fokusi kryesor mbetet promovimi dhe zhvillimi i punonjësve të saj. Kandidatët e brendshëm, në bazë të performancës së tyre, u konsideruan si potenciali kryesor për pozicionet vakante të shpallura në bankë. Kjo gjë krijon mundësi zhvillimi dhe ndërtimi të një karriere të sukseshme brenda institucionit dhe rritjen e motivimit të brendshëm tek punonjësit.

Për të përmbushur nevojat për staf në pozicione të nivelit bazë, kryesisht në Rrjetin e Degëve, janë rekrutuar 107 punonjës, ku studentët në Programin e Praktikës dhe Studentët e programit DSA janë burimi kryesor për plotësimin e këtyre pozicioneve.

Programi i Praktikës

Raiffeisen Bank ka krijuar traditën e saj të Programit të Praktikës. Synimi i saj është të tërheqë studentë me rezultate të larta, të cilët shfaqin një nivel të lartë motivimi, vullneti dhe dëshirë për të punuar në një mjedis financiar. Banka është e angazhuar ndaj Përgjegjësisë Sociale të Korporatës dhe programi i praktikës është një element i rëndësishëm i saj. Në mirëpresim studentë nga universitetet me reputacion të lartë në të gjithë vendin, në mënyrë që ata të mësojnë në praktikë mënyrën se si funksionon Banka dhe t'i ndihmojë ata të përgatiten për tregun e punës.

Programi Studentët DSA

Programi Studentët DSA gjatë vitit 2015 ka konsoliduar bashkëpunimin midis bankës dhe shumë universiteteve në vend. Fokusi i këtij programi, i inicuar nga Departamenti i Shitjeve & Marrëdhënie Direkte, është rritja e shitjeve të produkteve të ndryshme në degë. Gjatë këtij viti janë intervistuar një numër i madh studentësh rreth 639 dhe 236 prej tyre janë përzgjedhur për t'u bërë pjesë e këtij programi.

Studentët e përzgjedhur, të cilët punojnë si Agjentë të Shitjeve Direkte, ju ofrohet trajnim dhe suport nga shitës me eksperiencë gjatë gjithë programit një-vjeçar. Në fund të programit, ata fitojnë njohuri për produktet dhe proceset bankare dhe janë kandidatë potencialë për pozicionet vakante në bankë. Programi i Studentëve DSA ka nxitur dhe shtuar biznesin në degë gjithashtu ka qenë një prurje shumë e mirë edhe në burime njerëzore.

Trajnimi

Raiffeisen Bank përveç përpjekjeve për të tërhequr dhe selektuar punonjësit më të mirë në treg, është gjithashtu e angazhuar ndaj zhvillimit dhe rritjes së aftësive profesionale dhe njohurive të tyre. Programet e trajnimit dhe zhvillimit janë një investim strategjik për arritjen e objektivave të biznesit. Raiffeisen Bank ofron një Paketë Trajnimi për të gjithë punonjësit e rinj. Kjo paketë trajnimi është shumë e rëndësishme sepse u prezanton detyrat e reja që duhet të kryejnë dhe u mundëson një integrim sa më të lehtë në vendin e punës. Stafit të bankës u ofrohen mundësi për zhvillim dhe kualifikim edhe gjatë punësimit të tyre. Banka ka ofruar një sërë programesh trajnimi dhe iniciativash të zhvillimit profesional, të cilat janë organizuar me lektorë nga burime të brendshme ose ekspertë të jashtëm. Gjatë vitit 2015, plani vjetor i trajnimit reflekton kërkesat e secilit Departament për trajnime, çka synon të rrisë apo të rifreskojë njohuritë teknike

ose kompetencat/aftësitë që nevojiten për të përballuar sfidat dhe përmbushur rezultatet dhe objektivat e vendosura. Në këtë kuader, janë zhvilluar 4,213 ditë trajnimi në klasë dhe mbi 84 përqind e stafit kanë ndjekur të paktën një ditë trajnimi.

Përveç trajnimit në klasë, stafit të bankës i është ofruar mundësia që të ndjekë trajnime elektronike në platformën e-learning, e cila shërben si mjet për manaxhimin e njohurive dhe informacionit. Menuja e trajnimit në këtë platformë është pasuruar gjatë vitit 2015 me module të reja, sipas kërkesave të departamenteve të ndryshme. Kjo platformë përveç moduleve të zhvilluara nga vetë Banka, zhvillon trajnime të organizuara nga Grupi RBI. Numri i ditëve të trajnimit në trajnimet online arriti në total 2,080 për vitin 2015. Kjo shifër tregon interesin e gjerë në këtë metodë mësimdhënie, e cila ofron fleksibilitet, meqenëse modulet mund të ndiqen nga posti i punës dhe në momentin kur dëshiron vetë punonjësi.

Divizioni i Burimeve Njerëzore mbështet objektivat afatgjata të biznesit duke u fokusuar në zbatimin e Politikave të Manaxhimit të Talenteve dhe Planifikimit të Zhvillimit të Pasuesve. Banka është e fokusuar në identifikimin e punonjësve të cilët demonstrojnë potencial të lartë për arritje dhe performancë konstante, dhe zbaton plane për zhvillimin, ruajtjen dhe angazhimin e tyre.

Edukimi i Liderit dhe Manaxhimit është një tjetër fokus i Raiffeisen Bank. Programi i Trajnimit për Manaxhimin, i ofruar gjatë vitit 2015, synon të përforcojë kompetencat dhe sjelljet që menaxherët e bankës duhet të reflektojnë në mënyrë që të udhëheqin skuadrat e tyre drejt suksesit të vazhdueshëm.

Programet e rotacionit ishin një tjetër mjet zhvillimi, i ofruar për zhvillimin e stafit të Raiffeisen Bank. Këto programe u ofruan në nivel grupi dhe në nivel lokal. Objektivi i këtyre iniciativave është shkëmbimi i eksperiencave, njohurive dhe praktikave më të mira duke kryer vizita tek kolegët në departamente të tjera, brenda dhe jashtë bankës.

Politika e Shpërblimit në Raiffeisen Bank

Në Raiffeisen Bank politika e shpërblimit hartohet nga Burimet Njerëzore dhe aprovohet nga Bordi Drejtues dhe Bordi Mbikqyrës. Kjo politikë aplikohet për të gjithë punonjësit e bankës dhe filialet e bankës.

Fokusi i politikës së shpërblimit është plotësimi i standarteve ndërkombëtare me qëllim krijimin e një strukture kompesimi të drejtë dhe transparente sipas kërkesave aktuale të enteve rregullatore. Politika e shpërblimit në Raiffeisen Bank është konsistente dhe nxit frymën e menaxhimit të një risku efektiv dhe nuk inkurajon marrjen përsipër të riskut i cili tejkalon nivelin e lejuar të tij. Kjo politikë është në të njëjtën linjë me strategjinë e biznesit, objektivat, vlerave dhe interesave afatgjatë të grupit RZB dhe të Raiffeisen Bank në Shqipëri dhe përfshin masat për të shmangur konfliktin e interesit. Banka çdo vit identifikon funksionet/punonjësit me ndikim material në profilin e riskut të bankës. Këta punonjës përcaktohen si "Identified Staf" (Staf i Identifikuar) dhe procesi i tyre përzgjedhës bazohet në kërkesat/direktivat e grupit.

Kategoritë e "Identified Staff" janë si më poshtë:

1 – Material ose "Identified Staff" me ndikim të plotë. Kjo kategori ka një ndikim material direkt në riskun e profilit të bankës, sepse niveli i riskut i cili mund të merret individualisht ose në grup, mund të ketë një ndikim thelbësor në rezultatet dhe pasqyrat financiare të bankës. Numri i punonjësve të cilët plotësojnë këto kritere është 33 dhe përfshin Bordin Mbikqyrës, Drejtorin e Përgjithshëm, Bordin Drejtues, Drejtuesit e Divizioneve, Drejtuesit e Departamenteve dhe Përgjegjës Sektorit.

2 – Pjesërisht Material ose "Identified Staff" me ndikim jo të plotë. Kjo kategori ka një ndikim në profilin e riskut të bankës, por jo domosdoshmërisht në një mënyrë të drejtëpërdrejtë. Numri i punonjësve të cilët plotësojnë këto kritere është 36 dhe përfshin Drejtuesit e Divizioneve, Drejtuesit e Departamenteve, Drejtuesit e Distrikteve dhe Përgjegjës Sektorit.

Paga dhe përfitimet e tjera mbi pagën për punonjësit përcaktohen nga banka, duke synuar nivele të kënaqshme dhe konkurruese. Politika e ndjekur nga banka në përcaktimin e sistemit dhe strukturës së pagave duhet të realizojë dhe garantojë arritjen e pesë objektive kryesore:

- Shpërblimi për performancën dhe cilësinë e punës.
- Mbajtjen e bankës në një pozicion konkurrues në treg. Kompensimi i përgjithshëm duhet të jetë në çerekun e tretë të tregut vendas (midis 50 dhe 75 përqind), ndërsa për pozicionet drejtuese duhet të jetë në nivelin më të lartë të tregut, ndërmjet 75 përqind dhe 100 përqind.
- Motivimin e punonjësve nëpërmjet shpërblimit (pagës) të diferencuar për përgjegjësi, pozicione pune dhe aftësi profesionale të diferencuara.
- Përfitimet shtesë duhet të jenë konkurruese, por jo kryesuese në treg.
- Shpenzimet për pagat në totalin e kostos së personelit dhe buxhetit të bankës në tërësi të jenë në parametra të pranueshëm.

Për pozicionet drejtuese të nivelit të mesëm (Middle Management) dhe për stafin shitës, paga në Raiffeisen Bank është

e përbërë nga dy elemente:

- Paga bazë (Paga)
- Paga variabël

Struktura e pagës bazë

- Përfaqëson të ardhurat bruto, duke përjashtuar bonuset dhe përfitimet e tjera shtesë;
- administrohet në bazë të niveleve të pagës, të cilat bazohen në strukturën e gradës, nivelin e jetesës në vend dhe të dhënat e tregut.

Paga Variabël (Bonusi dhe skemat nxitëse)


- Është e lidhur ngushtë me rezultatet e performancës të Grupit RBI/ Bankës/Individit.
- Ka një kufi, në mënyrë që të sigurohet një manaxhim i buxhetit brenda parametrave të arsyeshëm, pa shkelur parimin e shpërblimit të performancës së lartë.
- Nuk do të jetë më e lartë se:
 - 16 përqind e pagës bazë mujore/vjetore për funksionet e shitjes
 - 12 përqind e pagës bazë mujore/vjetore për funksionet mbështetëse të biznesit
- Mund të paguhet me para, në të mira ose shërbime ose në instrumenta të tjerë sipas vendimit të Bordit Mbikqyrës.
- Në rastin e "Identified Staff" aplikohet një skemë e veçantë nëse vlera totale variabël e kompesimit është mbi 30,000 Euro.

Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues (shumat në Lekë '000)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal	E menjëhershme/për periudhën aktuale Viti 2015	Për periudha të kaluara Viti 2014
Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit	34,070	17,673
Cash/bonus	34,070	17,673
Aksione		
Të tjera		
Elementë të ndryshueshëm të shpërblimit		
Cash/bonus		
Aksione		
Të tjera		

Format dhe elementët e shpërblimit për Drejtuesit ekzekutivë (shumat në Lekë '000)

Vlera totale e agreguar e pagesave dhe shpërblimeve për vitin aktual fiskal	E menjëhershme/për periudhën aktuale Viti 2015	Për periudha të kaluara Viti 2014
Elementë të pandryshueshëm të shpërblimit	172,782	134,346
Cash/bonus	172,782	134,346
Shares		
Other		
Variable remuneration	29,255	39,959
Cash/bonus		
Shares	2,199	1,781
Other	27,056	38,178



KRUJA

Kruja/ Croia

Emri i qytetit është i lidhur me fjalën "kroi" (e shquar "krua").
Pikat turistike më tërheqëse janë muzeu i Skënderbeut dhe muzeu etnografik kombëtar.



RAIFFEISEN BANK SH.A.

Pasqyrat e konsoliduara sipas
Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit
Financiar dhe Raporti i audituesit të pavarur
31 dhjetor 2015

Pasqyra përmbledhëse

INFORMACION I PËRGJITHSHËM	164
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	165
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR	166
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	167
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	169
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSIT TË PARASË	170
1. Hyrje	171
2. Bazat e përgatitjes	171
3. Politikat kontabël të rëndësishme	171
4. Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël	181
5. Adoptimi i standardeve të reja të rishikuara dhe interpretimet	182
6. Deklarime të reja kontabël	182
7. Paraja dhe ekuivalentët e saj	183
8. Shuma të kushtëzuara	184
9. Investime në letra me vlerë	185
10. Hua dhe paradhënie për klientët	187
11. Aktiv tatimor i shtyrë	197
12. Emri i mirë	197
13. Aktive jo-materiale	198
14. Ndërtesa dhe pajisje	199
15. Aktive të tjera	200
16. Detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve bankare	200
17. Detyrime ndaj klientëve	201
18. Detyrime të tjera	203
19. Borxhi i varur	204
20. Kapitali	204
21. Rezerva të tjera	204
22. Interesi jo kontrollues	204
23. Të ardhura nga interesat	205
24. Shpenzime interesi	206
25. Të ardhura nga komisionet	206
26. Shpenzime komisioni	206
27. Të ardhura neto nga tregtimi	206
28. Të ardhura të tjera operative	206
29. Primi i sigurimit të depozitave	207
30. Shpenzime personeli	207
31. Shpenzime të përgjithshme administrative	207
32. Tatimi mbi fitimin	208
33. Administrimi i rrezikut financiar	208
34. Administrimi i kapitalit	218
35. Entitetet e strukturuar të pakonsoliduara	219
36. Angazhime dhe detyrime të mundshme	220
37. Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare	221
38. Paraqitja e instrumentave financiarë sipas kategorisë së matjes	223
39. Palët e lidhura	224
40. Ngjarje pas datës së raportimit	225

Informacion i përgjithshëm

Drejtesit dhe Administratorët më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014

Këshilli Drejtues (Këshilli Mbikëqyrës)

Helmut Breit	Kryetar
Heinz Hodl	Anëtar
Razvan Munteanu	Anëtar
Harald Kreuzmair	Anëtar
Andreas Engels	Anëtar

Komiteti i Kontrollit

Heinz Hödl	Kryetar
Johannes Kellner	Anëtar
Susana Benoit	Anëtar

Bordi Drejtues

Christian Canacaris	Drejtor Ekzekutiv
Alexander Zsolnai	Nën kryetar i Bordit të Drejtimit
John McNaughton	Anëtar
Elona Mullahi	Anëtar

Selia e regjistruar

Rruga e Kavajës, Ndërtesa 71, Apt. 4
Tiranë, Shqipëri
Telefon: +355 4 2381 381
Fax +355 4 2275 599

Auditues

Deloitte Audit Albania sh.p.k.
Rruga Elbasanit, Pallati poshte Fakultetit Gjeologji - Miniera,
Tirana, Albania
Telefon: +355 (4) 451 7920/ 451 7954
Facsimile: +355 (4) 451 7990

Raporti i Auditorit të Pavarur

Deloitte.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.
Rr. Elbasanit
Pallati poshte Fakulteti Gjeologji-
Miniera
Tirana, Albania
Tel: +355 4 45 17 920
www.deloitte.al

Aksionarit dhe Drejtimit të Raiffeisen Bank Sh.a.:

VAT (NUIS) No: L41709002H

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëngjitur të Raiffeisen Bank sh.a. dhe filialeve të saj ("Grupi"), të cilat përmbajnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për pasqyrat financiare të konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara bazuar mbi auditimin tonë. Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të konsoliduara nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimi për shumat dhe informacionet e paraqitura në pasqyrat financiare të konsoliduara. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke marrë parasysh edhe vlerësimin e rrezikut për pasaktësi materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, si rezultat i mashtrimit apo gabimeve. Në bërjen e këtyre vlerësimeve mbi rrezikun, audituesi konsideron kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara, në mënyrë që të përcaktojë procedurën auditimi të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të konsoliduara.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë bazë të arsyeshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më 31 dhjetor 2015, performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u audituan nga një tjerër auditues, i cili shprehu një opinion të pakualifikuar mbi këto pasqyra më 14 prill 2015.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.

10 mars 2016

Tiranë, Shqipëri

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touche Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see <http://www.deloitte.com/al/about> for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touche Tohmatsu Limited and its member firms.

Member of Deloitte Touche Tohmatsu Limited

Elvis Ziu
Elvis Ziu
Partner Angazhimi

DELOITTE AUDIT ALBANIA
Rr. Elbasanit, Pll. nr. 41 L. poshte Fakulteti Gjeologji Miniera
Tel: 044517920
NIPT: L 41709002 H TIRANA - ALBANIA

Pasqyra e konsoliduar pozicionit financiar më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK'000)

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Aktivët			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	7	78,056,475	40,638,657
Shuma të kushtëzuara	8	28,632,318	22,850,572
Investime të mbajtura për tregtim	9.1	20,998,043	28,517,255
Investime të mbajtura deri në maturim	9.2	51,955,158	59,579,093
Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë	9.3	3,423,858	6,841,526
Hua dhe paradhënie për klientët	10	100,896,697	112,216,171
Parapagim i tatimit mbi fitimin		614,274	118,504
Aktiv tatimor i shtyrë	11	33,271	44,629
Emri i mirë	12	92,783	92,783
Aktive afatgjata jomateriale	13	1,601,633	1,518,912
Ndërtesa dhe pajisje	14	1,587,464	1,652,506
Aktive të tjera	15	2,565,730	2,375,913
Totali i aktiveve		290,457,704	276,446,521
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	16	2,232,929	3,555,166
Detyrime ndaj klientëve	17	246,784,805	233,719,383
Detyrime të tjera	18	2,121,884	2,118,160
Borxh i varur	19	9,107,088	7,149,792
Totali detyrimeve		260,246,706	246,542,501
Kapitali			
Kapitali aksionar	20	14,178,593	14,178,593
Fitimi i pashpërndarë		12,795,084	12,788,710
Rezerva të tjera	21	3,135,352	2,835,352
Aktivët neto që i atribuohen aksionarëve Bankës		30,109,029	29,802,655
Interesi i Pakontrollueshëm	22	101,969	101,365
Totali i kapitalit		30,210,998	29,904,020
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		290,457,704	276,446,521

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës.



Christian Canacaris
Drejtor i Përgjithshëm



Alexander Zsolnai
Nën Kryetar i Bordit Drejtues

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 170 deri në 225, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK'000)

PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMBLEDHËSE

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga interesat	23	10,479,384	12,669,923
Shpenzime për interesa	24	(664,947)	(1,472,518)
Të ardhura neto nga interesat		9,814,437	11,197,405
Humbje neto nga zhvlerësimi i huave	10,18	(4,251,269)	(4,099,839)
Të ardhura neto pas zhvlerësimi te huave		5,563,168	7,097,566
Të ardhura nga komisionet	25	2,539,209	2,415,136
Shpenzime për komisionet	26	(449,397)	(375,012)
Të ardhura neto nga komisionet		2,089,812	2,040,124
Humbje nga instrumenta mbrojtës derivativë		(5,871)	-
Të ardhura neto nga investimi	9,3	120,053	4,496
Të ardhura neto nga tregtimi	27	2,130,729	2,546,883
Shpenzime të tjera operative, neto	28	(926,976)	306,114
		1,317,935	2,857,493
Primi i sigurimit të depozitave	29	(675,379)	(745,867)
Shpenzime për personelin	30	(2,498,988)	(2,423,966)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	13,14	(686,422)	(666,359)
Shpenzime të përgjithshme administrative	31	(2,621,489)	(2,208,240)
		(6,482,278)	(6,044,432)
Fitimi para tatimit		2,488,637	5,950,751
Tatimi mbi fitimin	32	(441,822)	(912,189)
Fitimi neto për vitin		2,046,815	5,038,562
Të ardhura të tjera përmbledhëse			
Zëra që mund të riklasifikohen më pas në fitim humbje:			
Investime të mbajtura për qëllime shitje:			
- Fitime minus humbje që rezultojnë gjatë vitit			
- Fitime minus humbje që mund të riklasifikohen në fitim humbje pas nxjerrjes jashtë përdorimit ose zhvlerësimit			
Të ardhura të tjera përmbledhëse për vitin			
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin		2,046,815	5,038,562

PASQYRA E KONSOLIDUAR E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA PËRMBLEDHËSE (VAZHDIM)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fitimi i atribuohet:		
- Aksionarëve të bankës	2,031,506	5,023,857
- Interesi i pakontrollueshëm	15,309	14,705
Fitimi për vitin	2,046,815	5,038,562
Totali i të ardhurave përmbledhëse i atribuohet:		
- Aksionarëve të bankës	2,031,506	5,023,857
- Interesi i pakontrollueshëm	15,309	14,705
Totali i të ardhurave përmbledhëse për vitin	2,046,815	5,038,562
Fitimet për aksion nga fitimet që i atribuohen aksionarëve të Bankës, bazë dhe të pakësuar (shprehur në lekë për aksion)	290,215	717,694

Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse duhet të lexohet së bashku me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara të paraqitura në faqet 170 deri në 225.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2015
(shumat në LEK'000)

	I atribuohen aksionarëve të Bankës						
	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva e rivlerësimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali	Interesi i Pakontrollueshëm	Totali i kapitalit
Teprica më 1 janar 2014	14,178,593	2,835,352	-	13,233,130	30,247,075	102,548	30,349,623
Dividend i paguar gjatë vitit	-	-	-	(5,468,277)	(5,468,277)	(15,888)	(5,484,165)
Fitimi i vitit	-	-	-	5,023,857	5,023,857	14,705	5,038,562
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-	5,023,857	5,023,857	14,705	5,038,562
Teprica më 31 dhjetor 2014	14,178,593	2,835,352	-	12,788,710	29,802,655	101,365	29,904,020
Transferimi nga fitimi i pashpërndarë në rezerva e përgjithshme	-	300,000	-	(300,000)	-	-	-
Dividend i paguar gjatë vitit	-	-	-	(1,725,132)	(1,725,132)	(14,705)	(1,739,837)
Fitimi i vitit	-	-	-	2,031,506	2,031,506	15,309	2,046,815
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-	2,031,506	2,031,506	15,309	2,046,815
Teprica më 31 dhjetor 2015	14,178,593	3,135,352	-	12,795,084	30,109,029	101,969	30,210,998

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital duhet lexuar së bashku me shënimet të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare të konsoliduara të paraqitura në faqet 10 deri në 71.

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 (shumat në LEK'000)

Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Fitimi para tatimit	2,488,637	5,950,751
<i>Zëra jo-monetarë në pasqyrën e konsoliduar gjithëpërfshirëse e të ardhurave</i>		
Zhvlërësimi dhe amortizimi	13,14	686,422
Fitim nga shitja e aktiveve të qendrueshme	28	(54,959)
Humbje nga zhvlërësimi neto nga aktivet financiare		4,231,536
E ardhura neto nga interesat		(10,727,978)
Të ardhura neto nga rivlerësimi i instrumentave me vlerë të drejtë		(631,509)
Të ardhura neto nga rivlerësimi i instrumentave të përcaktuar me vlerë të drejtë		(97,037)
Ndryshimi në provigjone për debitorë të tjerë		(4,984)
Ndryshime në provigjone për detyrime të mundshme		740,195
Efekti i rivlerësimit të parasë dhe ekuivalentëve të saj		397,037
Fluksi parasë nga aktiviteti operacional përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues	(2,972,640)	(1,415,788)
(Rritje) / Rënie në shumat e kushtëzuara	(5,780,768)	1,676,452
Rënie në hua dhe paradhënie për klientët	6,121,410	303,571
Rënie e investimeve të tregtueshme	7,974,750	15,474,564
Rënie / (rritje) në letrat të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes	3,594,837	(6,782,862)
Rritje në aktive të tjera	(184,343)	(399,737)
Rënie në detyrimet ndaj institucioneve financiare	(603,594)	(1,453,157)
Rritje / (Rënie) në detyrimet ndaj klientëve	13,321,868	(10,959,407)
Rënie në detyrimet e tjera	(720,194)	(1,055,820)
Fluksi i parasë nga aktiviteti operacional pas ndryshimeve në kapitalin qarkullues	20,751,326	(4,612,184)
Interesa të fituara	11,573,587	13,506,752
Interesa të paguara	(947,976)	(3,342,801)
Tatimi mbi fitimin i paguar	(926,233)	(819,781)
Paraja neto e gjeneruar nga aktiviteti operacional	30,450,704	4,731,986
Fluksi i parasë nga aktiviteti investues		
Të ardhura nga shitja e letrave me vlerë të vlefshme për shitje		-
Blerje e ndërtesave dhe pajisjeve	14	(350,781)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	13	(314,680)
Të ardhura neto nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		16,318
Të ardhura neto nga blerja dhe maturimi i letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim		74,788,563
Blerje e letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim	(66,951,632)	(40,397,522)
Paraja neto e gjeneruar në aktivitetin investues	7,187,788	6,217,394
Fluksi i parasë nga aktiviteti financues		
Dividend i paguar nga fitimi i pashpërndarë nga viti i kaluar		(1,739,837)
Rritja në borxhin e varur	1,916,200	-
Paraja neto e gjeneruar / (përdorur) në aktivitetin financues	176,363	(5,484,165)
Rritje neto në para dhe ekuivalentët e saj gjatë vitit	37,814,855	5,465,215
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	7	40,638,657
Efekti i rivlerësimit të parasë dhe ekuivalentëve të saj		(397,037)
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit	7	78,056,475

The consolidated statement of cash flows is to be read in conjunction with the notes to and forming part of the consolidated financial statements set out on pages 10 to 73.

1. HYRJE

Këto pasqyra financiare të konsoliduara janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 për Raiffeisen Bank sh.a. ("Banka") dhe filialeve të saj ("Grupi").

Raiffeisen Bank Sh.a., më poshtë referuar ("Banka") është një institucion bankar i cili vepron në përputhje me Ligjin 9901, datë 14 Prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", dhe Ligjin 9662, datë 18 Dhjetor 2006 "Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë", si dhe me ligjet e tjera të rëndësishme. Banka është themeluar dhe vendosur në Shqipëri dhe zhvillon aktivitetin e saj operativ në Shqipëri. Raiffeisen Bank Sh.a. është bijë 100% e zotëruar nga Raiffeisen Bank International AG, Austri, e cila është pala kontrolluese finale.

Aktiviteti kryesor. Aktiviteti kryesor i biznesit të Grupit janë operacionet bankare me pakicë në kuadër të Republikës së Shqipërisë. Banka vepron nëpërmjet një rrjeti prej 89 vendodhje shërbimi më 31 dhjetor 2015 (31 Dhjetor 2014: 90 vendosje shërbimi) në të gjithë Shqipërinë, të cilat administrohen në 8 rrethe dhe nuk ka operacione jashtë shtetit.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë autorizuar për tu publikuar nga Bordi Drejtues më 9 mars 2016. Aprovimi i pasqyrave financiare nga Aksionarët do të kryhet në Mbledhjen Vjetore të Përgjithshme të Aksionarëve.

2. BAZAT E PËRGATITJES

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare të Grupit janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") sipas parimit të kostos historike, të modifikuara sipas njohjes fillestare të instrumentave financiar bazuar në vlerën e drejtë, dhe sipas rivlerësimit të aktiveve financiare të mbajtura për tregtim dhe instrumentat financiar përcaktuar me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitim humbjes. Politikat kryesore kontabël janë paraqitur më poshtë.

Monedha e prezantimit. Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe. Ndryshe siç tregohet, informacioni financiar i paraqitur në Lek është rumbullakosur në mijëshen më të afërt.

3. POLITIKAT KONTABËL TË RËNDËSISHME

Politikat kontabël në vijim janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe.

a) Konsolidimi i pasqyrave financiare

Filialet janë ato investime, përfshirë njësitë ekonomike të strukturuar, që Grupi i kontrollon sepse Grupi (i) ka fuqi për të drejtuar aktivitetet përkatëse të njësisë ku është investuar që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme kthimin e tyre, (ii) ka ekspozim, ose të drejta, të kthimit të ndryshueshme nga përfshirja e tij me njësinë ku është investuar, dhe (iii) ka aftësinë për të përdorur fuqinë e tij mbi të investuarit duke ndikuar në shumën e kthimit të investitorit. Ekzistenca dhe efekti i të drejtave substanciale, duke përfshirë të drejtat substanciale votuese potenciale, janë konsideruar kur vlerësohet nëse Grupi ka mundësi për një entitet tjetër. Që një e drejtë të jetë e pavarur, mbajtësi duhet të ketë aftësinë praktike për ta ushtruar atë të drejtë kur vendimet për drejtimin e aktiviteteve përkatëse të filialit duhet të bëhet. Grupi mund të ketë pushtet mbi një filial edhe kur ajo mban më pak se shumica e fuqisë votuese. Në një rast të tillë, Grupi vlerëson madhësinë e të drejtave të votimit në krhasim me madhësinë dhe shpërndarjen e zotërimeve të bartësve të tjerë të votave për të përcaktuar fuqinë në qoftë se ajo është de-facto mbi filialet. Të drejta mbrojtëse e investitorëve të tjerë, të tilla si ato që kanë të bëjnë me ndryshimet themelore të aktiviteteve të filialit ose të zbatohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, nuk ndalojnë Grupin nga kontrollimi i filialit. Filialet janë të konsoliduara nga data në të cilën kontrolli i transferohet Grupit, dhe janë të decentralizuara nga data në të cilën përfundon kontrolli.

Metoda e blerjes kontabël është përdorur për të kontabilizuar blerjen e filialeve. Aktivitetet e identifikueshme të blera dhe detyrimet dhe detyrimet e keqia të konstatuara në një kombinim biznesi janë matur me vlerën e tyre të drejtë në datën e blerjes, pavarësisht nga shtrirja e çdo interes jo-kontrollues. Grupi mat interesin jo-kontrollues që përfaqëson interesin e tanishëm të pronësisë dhe i jep të drejtë mbajtësit të një pjesë proporcionale të aktiveve neto në rast të likuidimit të një transaksioni me bazë transaksioni, qoftë në: (a) vlerën e drejtë, ose (b) mos kontrollimin e një pjesë proporcionale të interesit për aktivet neto të të blerit. Interesat jo kontrolluese që nuk përfaqësojnë interesat pronësore, maten me vlerën e drejtë. Emri i mirë matet duke zbritur aktivet neto të të blerit nga totali i kostos për të blerit, shuma e interesave jo-kontrolluese të të blerit dhe vlerës së drejtë të një interesi në të blerit mbajtur menjëherë përpara datës së blerjes. Çdo shumë negative ("emër i mirë negativ"), njihet në fitim ose humbje, pasi menaxhimi rivlerëson nëse ajo ka identifikuar të gjitha asetet e blera dhe të gjitha detyrimet e detyrimet e keqia, si dhe shqyrton përshtatshmërinë e matjes së tyre.

Tranferimi i pagesës për njësinë e blerë matet me vlerën e drejtë të aktiveve të dhëna, instrumentat e kapitalit të lëshuara dhe detyrimet nga marrëveshje të keqia, por përjashton blerjen e kostove tvlidhura si këshillimi, ligjori, vlerësimi dhe shërbime të ngjashme profesionale. Kostot e transaksionit që ndodhin gjatë lëshimit të instrumentave të kapitalit i zbriten kapitalit; transaksionet e ndodhura për lëshimin e borxhit i zbriten vlerës së mbartur dhe të gjitha transaksionet e tjera të lidhura me blerjen shpenzohen. Transaksionet midis kompanive, balancat dhe fitimet e pa-realizuara midis grupit të kompanive eliminohen; humbjet e përcaktuara gjithashtu eliminohen përveç rastit kur kostot nuk mund të recuperohen. Banka dhe të gjitha filialet përdorin politika kontabiliteti uniforme dhe konsistente me politikat e Grupit.

Bazuar në natyrën e aktivitetit, filialet e këtij Grupi kanë disa politika specifike të kontabilitetit të cilat janë detajuar në shënimin 3 (n) për Raiffeisen Leasing sh.a. dhe në shënimet 3 (t) dhe 3 (u), për Raiffeisen INVEST.

Blerjet dhe shitjet e interesave jo-kontrolluese. Grupi zbaton modelin e njësisë ekonomike për të kontabilizuar transaksionet me pronarët për interesin jo-kontrollues. Çdo diferencë midis shumës së blerjes dhe vlerës kontabël të interesave jo-

3. POLITIKAT KONTABEL TE RENDESISHME (VAZHDIM)

kontrolluese të fituar është regjistruar si një transaksion i kapitalit direkt në kapitalin neto. Grupi njih dallimin mes konsiderimit të shitjes dhe vlerës kontabël të interesave jo-kontrolluese të shitur si një transaksion kapitali në pasqyrën e ndryshimeve në kapital.

Interesat pjesëmarrës. Associates are entities over which the Group has significant influence (directly or indirectly), but not control, generally an interesat pjesëmarrës janë subjektet mbi të cilat Grupi ka ndikim të rëndësishëm (direkt ose indirekt), por nuk i kontrollojnë, zakonisht zotëron mes 20 dhe 50 për qind të të drejtave të votës. Investimet në interesa pjesëmarrës kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto, dhe njihen fillimisht me kosto. Vlera kontabël e interesave pjesëmarrës përfshin emrin e mirë të identifikuar të blerjes minus humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi, nëse ka. Dividendët e marrë nga interesat pjesëmarrës zvogëlojnë vlerën kontabël të investimit. Ndryshimet e tjera pas-blerjes në pjesën e Grupit të aktiveve neto të një pjesëmarrje njihen si vijon: (i) pjesa e Grupit në lidhje me fitimet ose humbjet e interesave pjesëmarrës të regjistruhen në pasqyrën e konsoliduar e të ardhurave për vitin si pjesë e rezultatit të sipërmarrjeve, (ii) pjesa e Grupit e të ardhurave të tjera përmbledhëse njihet në kapitalin neto dhe të paraqitura veçmas, (iii) të gjitha ndryshimet e tjera në pjesën e Grupit të vlerës kontabël të aktiveve neto të sipërmarrjeve njihen në fitim ose humbje brenda pjesës së rezultatit nga sipërmarrjet. Megjithatë, kur pjesa e humbjeve të Grupit në një pjesëmarrje e barabartë ose tejkalimi i interesit të tij në pjesëmarrje, duke përfshirë çdo të arkëtueshme tjetër të pasigurtë, Grupi nuk njih humbje të mëtejshme, nëse nuk i ka shkaktuar detyrime ose pagesa në emër të pjesëmarrjes. Fitimet e përcaktuara nga transaksionet midis Grupit dhe sipërmarrjeve të tij eliminohen deri në masën e interesit të Grupit ndaj sipërmarrjeve; humbjet e përcaktuara eliminohen gjithashtu, përveçse nëse transaksioni jep dëshmi për një zhvlerësim të aktivitetit të transferuar.

Aktivitet ponderohen në përputhje me kategoritë e gjera të rrezikut kombëtar, të cilave i caktohet një peshë rreziku në përputhje me sasinë e kapitalit të pashlyer që është i nevojshëm për mbështetjen e tyre. Aplikohen pesë kategori të ponderimit të rrezikut (0%, 20%, 50%, 100%, 150%); për shembull instrumentat e tregut të parasë kanë një peshë zero

34. ADMINISTRIMI I KAPITALIT (VAZHDIM)

në rrezik që do të thotë që për mbajtjen e këtyre aktiveve nuk nevojitet kapital. Aktivet afatgjata materiale mbajnë një peshë 100% të rrezikut, që do të thotë se duhet të mbështeten nga një kapital i njëjtë me 12% të vlerës kontabël. Krediti jashtë bilancit, që lidhet me angazhimet, gjithashtu merret në konsideratë. Me pas, sasi të peshohen me rrezikun duke përdorur të njëjtën përqindje si për aktivet në bilanc.

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Totali i aktiveve të ponderuara me rrezik	142,371,584	130,210,662
Kapitali rregullator	25,295,831	24,669,576
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	17.77%	18.95%

Politika e Bankës është që të mbajë një bazë të fortë kapitali të tillë që të mbajë besueshmërinë e investitorit, kreditorit dhe tregut dhe të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Impakti i nivelit të kapitalit në kthimet për aksion njihet gjithashtu dhe Banka njihet nevojën për të mbajtur një balancë ndërmjet kthimeve më të larta të mundshme nëpërmjet levave financiare dhe avantazheve të sigurisë që vijnë nga një pozicion më i qëndrueshëm dhe i favorshëm i kapitalit. Banka dhe operacionet e saj rregullative kanë qenë në përputhje me të gjitha kërkesat e kapitalit të vendosura nga jashtë gjatë të gjithë periudhës.

Kapitali rregullator i Shoqërive Administruese të fondeve të pensione ve vullnetare dhe fondeve investuese (filiali i Bankës)

Shoqëritë Administruese të fondeve të pensione ve vullnetare dhe fondeve investuese, bazuar në ligjin 10197 dhe 10198 datë 10 dhjetor 2009, në çdo kohë duhet të kenë një kapital të paktën 15,625 mijë Lek, i cili llogaritet duke zbritur detyrimet nga aktivet në pozicionin financiar të Fondit. Kur vlera neto e aktiveve në fondet e pensionit, të administruara nga shoqëria administruese, e kalon vlerën 31,250 milion Lek, shoqëria administruese duhet ta rrisë kapitalin, në mënyrë që shtesa e kapitalit të jetë të paktën e barabartë me 0,02% të vlerës me të cilën vlera neto e aktiveve të fondeve të administruara kalon pragun e përmendur. Megjithatë nuk është e nevojshme që kapitali të kalojë vlerën 1,250,000 mijë Lek. Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 Raiffeisen INVEST është në përputhje me kërkesat ligjore për kapital rregullator.

Kapitali rregullator i shoqërive të qiradhënies financiare (filiali i Bankës)

Bazuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për liçencimin e subjekteve jobanka" aktiviteti i qirasë financiare përfshihet në aktivitetet që kryejnë subjektet jobanka dhe përveç të tjerave, kërkesa për kapitalin minimal për fillimin e aktivitetit është 100,000 mijë Lek. Më 31 dhjetor 2015 dhe 2014, Raiffeisen Leasing sh.a. është në përputhje me kërkesat ligjore për kapital rregullator.

Politika e Grupit është që të mbajë një bazë të fortë kapitali të tillë që të mbajë besueshmërinë e investitorit, kreditorit dhe tregut dhe të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Impakti i nivelit të kapitalit në kthimet për aksion njihet gjithashtu, dhe Grupi njihet nevojën për të mbajtur një balancë ndërmjet kthimeve më të larta të mundshme nëpërmjet levave financiare dhe avantazheve të sigurisë që vijnë nga një pozicion më i qëndrueshëm dhe i favorshëm i kapitalit. Grupi dhe operacionet e tij rregullative individuale kanë qenë në përputhje me të gjitha kërkesat e kapitalit të vendosura nga jashtë, gjatë gjithë vitit.

Nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në administrimin e kapitalit të Grupit gjatë vitit.

35. ENTITETET E STRUKTURUARA TË PAKONSOLIDUARA

Bazuar në kërkesat e SNRF 10, ekspozimi ndaj kthimeve të ndryshueshme duhet të jetë shumë më lart se ekspozimi nga tarifat e menaxhimit të nivelit të tregut të aktiveve, në mënyrë që të merret në konsideratë konsolidim i fondeve që menaxhohen nga subjekti, në pasqyrat financiare. Ky nuk është rasti për Grupin, i cili ka të drejtë të 1,5% të vlerës neto të aktiveve të fondeve të investimit. Më tej, Grupi nuk ka në pronësi ndonjë njësi të investimeve në fondin e pensione ve

35. ENTITETET E STRUKTURUARA TË PAKONSOLIDUARA (VAZHDIM)

apo në fondet e investimeve. Aktivet e Fondit menaxhohen në formë unazë nga Shoqëria Administruese (filial i grupit). Sipas legjislacionit Shqiptar për fondet e pensione dhe fondet e investimeve, titulli ligjor mbi aktivet e Fondit mbetet me kontribuesit. Si pasojë, Grupi nuk ka konsoliduar ndonjë prej fondeve të administruara nga një prej filialeve të tij në pasqyrat financiare të konsoliduara 2015. Informacioni në lidhje me subjektet e pakonsoliduara të strukturuar është si vijon:

	Per vitin e mbyllur deri më 31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2015	
	Të ardhura për vitin	Vlera e mbartur e aktiveve të njohura për ekspozim ndaj entitetit	Vlera e mbartur e detyrimeve të njohura për ekspozim ndaj entitetit	Ekspozimi maksimal ndaj humbjes nga interesi të entitetit
<i>Në mijë lekë</i>				
Fondi Prestigj	697,009	56,778,032	144,389	56,633,644
Fondi i pensionit	4,118	325,620	1,322	324,298
Fondi Euro	160,403	10,372,516	17,008	10,355,508
TOTAL	861,530	67,476,168	162,719	67,313,450

36. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME

	LEK	Monedhë e huaj	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
			Totali	Totali
<i>Detyrime të mundshme</i>				
Garanci bankare të lëshuara	2,929,734	6,977,344	9,907,078	7,335,589
Letër kredi	-	2,763,180	2,763,180	3,702,307
Linja të papërdorura krediti	4,115,773	7,821,202	11,936,975	16,902,803
Totali	7,045,507	17,561,726	24,607,233	27,940,699

Pjesa më e madhe e garancive bankare dhe letër kredive të mësipërme janë për periudha kohore më pak se një vit dhe kanë si kolateral depozitat e bllokuara të klientëve.

Më 31 dhjetor 2015 Banka është përfshirë në procedura gjyqësore me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të Shqipërisë në lidhje me një vlerësim tatimor të kryer nga kjo e fundit gjatë 2014. Totali i detyrimeve shtesë dhe penalitetet që duhet të paguhet nga Banka janë 673 mln lekë. Taksat shtesë janë sfiduar nga Banka në Gjykatën e Qarkut. Në bazë të ligjit nr. 9920 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Banka ka lëshuar një garanci bankare që mbulon detyrimet dhe jo penalitetet e vlerësimit tatimor për një shumë prej 530 lekë mln në favor të Autoriteteve Tatimore. Menaxhimi synon të mbrojë fuqishëm qëndrimet dhe interpretimet Bankes që u sfiduan nga autoritetet tatimore. Në bazë të vlerësimeve të veta dhe si këshilla ligjore të brendshme dhe të jashtme, menaxhimi është i mendimit se nuk ka humbje materiale do të lindin në lidhje me pretendimet, dhe në përputhje me rrethanat asnjë dispozitë nuk është rezervuar në pasqyrat financiare.

Angazhimet për qiratë e zakonshme operative

Grupi ka hyrë në angazhime të pakthyeshme qiraje të zakonshme operative për Drejtorinë e Përgjithshme dhe degët. Angazhime të tilla më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 janë si më poshtë:

36. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME (VAZHDIM)

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Jo më vonë se 1 vit	360,779	376,926
Më vonë se 1 vit dhe jo më vonë se 5 vjet	915,602	550,239
Më vonë se 5 vjet	-	62,586
Totali	1,276,381	989,751

37. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE

Matjet e vlerës së drejtë analizohen nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë si më poshtë: (i) niveli parë janë një matje me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për aktive ose detyrime të njëjta, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknika të vlerësimit me të gjitha inputet materiale të vëzhgueshme për aktivin ose pasivin në mënyrë të drejtpërdrejtë (që është, si çmimet) ose indirekt (domethënë, rrjedhin nga çmimet), dhe (iii) të nivelit të tre matjet janë vlerësimet jo të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme në treg (pra, jo të inputeve vëzhgueshme). Drejtimi aplikon gjykimin në kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse matja e një vlere të drejtë përdor të dhëna të vëzhgueshme që kërkojnë rregullim të rëndësishëm, ajo matje është matje e Nivelit 3. Rëndësia e një inputi vlerësimi vlerësohet kundrejt matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e tij. Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë janë ata që standarde të kontabilitetit kërkojnë ose lejojnë në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të çdo periudhe raportuese.

Vlerat e drejta të analizuar nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë dhe vlerat kontabël të aktiveve jo të matura me vlerën e drejtë janë si më poshtë:

	2015			Totali
	Vlera e drejtë Nivel 1	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3	
Hua dhe paradhanie me bankat	-	30,064,621	29,376,864	59,441,485
Hua dhe paradhanie për klientët	-	-	100,896,697	100,896,697
Letrat me vlerë të tregëtueshme	-	20,998,043	-	20,998,043
Investime të mbajtura në maturim	-	52,522,296	-	52,522,296
Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	-	6,841,526	-	6,841,526
Detyrime nga bankat	-	4,811	2,228,118	2,232,929
Depozita nga klientët	-	-	246,794,215	246,794,215
Borxhi i varur	-	9,107,088	-	9,107,088
Garanci dhe angazhime	-	1,639,967	22,967,266	24,607,233

Vlerat e drejta të analizuar nga niveli në hierarkinë e vlerës së drejtë dhe vlerat kontabël të aktiveve jo të matura me vlerën e drejtë për vitin 2014 janë si më poshtë:

	2014			Totali
	Vlera e drejtë Nivel 1	Vlera e drejtë Nivel 2	Vlera e drejtë Nivel 3	
Hua dhe paradhanie me bankat	-	20,128,723	43,360,507	63,489,230
Hua dhe paradhanie për klientët	-	-	112,697,286	112,697,286
Letrat me vlerë të tregëtueshme	-	28,517,254	-	28,517,254
Investime të mbajtura në maturim	-	59,605,075	-	59,605,075

37. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE (VAZHDIM)

Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes	-	6,841,526	-	6,841,526
Detyrime nga bankat	-	194,890	3,360,277	3,555,167
Depozita nga klientet	-	-	233,669,736	233,669,736
Borxhi i varur	-	-	7,251,731	7,251,731
Garanci dhe angazhime	-	-	33,387	33,387

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshin depozita ndërmjet bankave dhe mjete të tjera në procesin e arkëtimit. Duke qënë se këto balanca kanë afat të shkurtër dhe janë me norma interesi të ndryshueshme, vlera e drejtë e tyre është pothuajse e barabartë me vlerën kontabël.

Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letrat me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e rrjedhjeve të skontuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur. Instrumentat e mbajtur deri në maturim klasifikohen në nivelin 2 sepse tregu për këta instrumente është më pak aktiv.

Hua dhe paradhënie klientëve

Huatë dhe paradhëniet mbarten me vlerën e mbetur pakësuar nga provigjonet. Portofoli i huave të Grupit ka një vlerë të drejtë të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të afatit të shkurtër ose normave të interesit të afërta me normat e tregut. Pjesa më e madhe e portofolit të huave është subjekt i rçmimeve brenda një viti..

Detyrime nga/ ndaj bankave dhe institucioneve financiare

Vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve ndaj bankave dhe institucioneve financiare është pothuajse e barabartë me vlerën e tyre të mbartur për shkak të afatit të shkurtër ose normave të interesit të përafërta me normat e tregut.

Depozita nga klientët

Vlera e drejtë e depozitave pa afat, që përfshin dhe depozitat pa interes, është vlera që i paguhet klientit sipas kërkesës.

Borxhi i varur

Vlera e drejtë e borxhit të varur ka një vlerë të drejtë që i afrohet vlerës së tij kontabël për shkak të normës së tij të interesit që i për afrohet normave të tregut.

Garancitë dhe angazhimet

Vlera e drejtë e garancive dhe angazhimeve, kryesisht përbëhen nga primet e paamortizuara dhe të pranuarra për lëshimin e garancive.

Sensitiviteti i vlerës së drejtë

Përshkrimi i teknikës së vlerësimit dhe përshkrimi i inputeve të përdorura në matjen e vlerës së drejtë për të nivelit 2 matjet në 31 dhjetor 2015 ishte si më poshtë:

Në mijë LEK	Vlera e drejtë	Teknika e vlerësimit	Inputet e përdorura
Aktivt financiarë me vlerën e drejtë			
Letra me vlerë të tregtueshme			
Bono thesari shqiptare	1,932	Rrjedha e parasë e skontuar (RPS)	Kurba e bonove qeveritare
Obligacione qeveritare	20,996,111	RPS	Kurba e bonodeve qeveritare
Të tjera letra me vlerë të vlerësuarra nëpërmjet fitimit ose humbjes			
Obligacione qeveritare	3,423,858	RPS	Kurba e bonodeve qeveritare

37. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE (VAZHDIM)

Përshkrimi i teknikës së vlerësimit dhe përshkrimi i inputeve të përdorura në matjen e vlerës së drejtë për të nivelit 2 matjet në 31 dhjetor 2014 ishte si më poshtë:

Në mijë LEK	Vlera e drejtë	Teknika e vlerësimit	Inputet e përdorura
Aktivet financiare me vlerën e drejtë			
Letra me vlerë të tregtueshme			
Bono thesari shqiptare	1,332	Rrjedha e parasë e skontuar (RPS)	Kurba e bonove qeveritare
Obligacione qeveritare	28,339,952	RPS	Kurba e bonodeve qeveritare
Të tjera letra me vlerë të vlerësuarra nëpërmjet fitimit ose humbjes			
Obligacione qeveritare	6,841,526	RPS	Kurba e bonodeve qeveritare

38. PARAQITJA E INSTRUMENTAVE FINANCIARË SIPAS KATEGORISË SË MATJES

Për qëllime matjeje, SNK 39 "Instrumentat financiarë: Njohja dhe Matja", i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme: (a) hua dhe paradhënie; (b) aktive financiare të mbajtura për shitje; (c) aktive financiare të mbajtura në maturim dhe (d) aktive financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarive të fitim humbjes ("FVTPL"). Aktivet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarive të fitim humbjes ndahen në dy kategori: (i) aktive të destinuar si të tilla që në njohje dhe (ii) ato të klasifikuara të mbajtura për tregtim. Qeraja financiare është një kategori më vete. Tabela e mëposhtme paraqet aktivet financiare sipas këtyre kategorive të matjes në 31 dhjetor 2015:

	Hua dhe paradhënie	Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimi ose humbjes	Investime të mbajtura për tregtim	Investime të mbajtura në maturim	Totali
Aktivet					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	78,056,475	-	-	-	78,056,475
Shuma të kushtëzuara	28,632,318	-	-	-	28,632,318
Investime të mbajtura për tregtim	-	-	20,998,043	-	20,998,043
Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes	-	3,423,858	-	-	3,423,858
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	51,955,158	51,955,158
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	97,266,811	-	-	-	97,266,811
Qera financiare e arketueshme	3,629,886	-	-	-	3,629,886
Total Aktive financiare	207,585,490	3,423,858	20,998,043	51,955,158	283,962,549

38. PARAQITJA E INSTRUMENTAVE FINANCIARË SIPAS KATEGORISË SË MATJES (VAZHDIM)

Tabela e mëposhtme paraqet aktivet financiare sipas këtyre kategorive të matjes në 31 dhjetor 2014:

	Hua dhe paradhënie	Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitimi ose humbjes	Investime të mbajtura për tregtim	Investime të mbajtura në maturim	Totali
Aktivët					
Paraja dhe ekuivalentët e saj	40,638,657	-	-	-	40,638,657
Shuma të kushtëzuara	22,850,572	-	-	-	22,850,572
Investime të mbajtura për tregtim	-	-	28,517,255	-	28,517,255
Investime të përcaktuara me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes	-	6,841,526	-	-	6,841,526
Investime të mbajtura deri në maturim	-	-	-	59,579,093	59,579,093
Hua dhe paradhënie për klientët, neto	112,216,171	-	-	-	112,216,171
Total Aktive financiare	175,705,400	6,841,526	28,517,255	59,579,093	270,643,274

Në 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014, të gjitha detyrimet financiare të Grupit përveç derivativeve mbahen me vlerë të mbetur.

39. PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen në përgjithësi të jenë të lidhura në qoftë se palët janë nën kontroll të përbashkët, ose njëra palë ka aftësinë për të kontrolluar palën tjetër ose mund të ushtrorë ndikim të rëndësishëm mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale. Kur konsiderohet çdo marrëdhënie ndërmjet palëve, vëmendje i kushtohet përmbajtjes së marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore.

Banka ka marrëdhënie me palë të lidhura me Raiffeisen International AG, Raiffeisen Zentralbank Osterreich Aktiengesellschaft, me filialet dhe filialeve e tze Raiffeisen Leasing sh.a. dhe Raiffesien Invest sh.a., dhe me drejtorët e tij dhe zyrtarët ekzekutiv.

Grupi i jep hua për të dhe ka marrë depozita nga subjektet e tjera të ngjashme. Kreditë dhe depozitat e tilla janë individualisht të parëndësishme dhe janë futur në përgjithësi në kushte të lira tregu.

Vlera totale e transaksioneve dhe bilanceve të papaguara lidhen me këto palët e lidhura ishin si vijon:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Kërkesa nga		
Kompania mëmë e drejtpërdrejtë	19,575,831	8,802,373
Të tjera kompani të lidhura	84,904	59,931
Totali i aktiveve	19,660,735	8,862,304
Detyrimet ndaj		
Kompania mëmë e drejtpërdrejtë	(9,169,088)	(7,390,573)
Të tjera kompani të lidhura	(12,320)	(88,772)
Totali i detyrimeve	(9,181,408)	(7,479,345)

39. PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2015	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhurat nga interesi, neto		
Kompania mëmë e drejtpërdrejtë	(494,862)	(433,138)
Të tjera kompani të lidhura	27,351	37,604
Totali të ardhurat nga interesi, neto	(467,511)	(395,534)
Shpenzime komisioni, neto		
Kompania mëmë e drejtpërdrejtë	(36,461)	(21,378)
Të tjera kompani të lidhura	(157,103)	(158,430)
Totali shpenzime komisioni, neto	(193,564)	(179,808)
Shpenzime administrative		
Kompania mëmë e drejtpërdrejtë	(448,215)	(468,462)
Të tjera kompani të lidhura	(3,086)	(35,382)
Totali shpenzime administrative	(451,301)	(503,844)
Totali	(1,112,376)	(1,079,186)

Të përfshira në shumat e detyrueshme ndaj prindit të drejtpërdrejtë është borxhi i varur, i cili është detajuar në shënimin 19.

Personeli kyç i manaxhimit

Vlera totale e transaksioneve dhe bilanceve të papaguara që lidhen me personelin drejtues kryesor ishin si më poshtë:

	2015	2014
Pasqyra e pozicionit financiar		
Detyrimet nga	214,363	108,518
Detyrimet ndaj	(122,513)	(74,535)
Tepriat neto	91,850	33,983
Shpenzime		
Pagat dhe shpërblimet	(293,899)	(232,940)
Totali	(293,899)	(232,940)

40. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Pas ngjarjeve të ndodhura pas datës së raportimit në lidhje me dy klientë në segmentin e korporatave, të lidhura me përkeqësimin e situatës financiare të këtyre klientëve, Drejtimi i Bankës është në procesin e vlerësimit të ndikimit të këtyre ngjarjeve në pozicionin financiar dhe në performancën financiare të Grupit. Drejtimi gjykon se këto ngjarje nuk ndikojnë pozicionin financiar apo performancën financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015, por do të reflektohen në periudhat e ardhshme financiare.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit, të cilat kërkojnë rregullim apo paraqitje në pasqyrat financiare të konsoliduara.

KORÇA

Korça, është qendër e rëndësishme e Rilindjes Kombëtare. U hap shkolla e parë fillore në gjuhën shqipe nga Organizata Drita në vitin 1887 dhe në 1891 u hap shkolla e parë për vajza nga familja Qirjazi, e cila në 1968 u kthye në Muzeun e Arsimit.





Raiffeisen Leasing në Shqipëri

Gjatë vitit 2015, Raiffeisen Leasing në Shqipëri arriti të forcojë më tej pozitën e saj si numri një në tregun shqiptar të financimit nëpërmjet qirasë financiare. Në këtë rritje ka ndikuar edhe finalizimi i marrëveshjes së blerjes së portofolit të kompanisë së qirasë financiare Tirana Leasing Sh.a, pjesë e Grupit Bankar të Pireut. Kjo ishte lëvizja më e rëndësishme në fushën e blerjeve midis kompanive të leasing-ut, që formalizohet në tregun financiar shqiptar, e miratuar gjithashtu edhe nga Autoriteti i Konkurrencës.

Me blerjen e portofolit të Tirana Leasing Sh.a, Raiffeisen Leasing ka arritur të rrisë portofolin me 32 përqind, numrin e asetëve të financuara me 50 përqind si dhe ka zgjeruar numrin e klientëve, sidomos ata individë. Blerja e portofolit të Tirana Leasing ka rritur ndjeshëm dominimin e Raiffeisen Leasing në treg me një pjesëmarrje me më shumë se 60 përqind të tij.

Vlera e financuar për vitin 2015, ka arritur shifrat 12,012 milionë Euro, ku 10,388 milion Euro janë për mjete të lëvizshme dhe 1,624 milionë Euro për pajisje. Raiffeisen Leasing ashtu si edhe një vit më parë ka shperndarë dividendë tek aksioneret e tij. Produktet kryesore të Raiffeisen Leasing janë financimi i mjeteve të lëvizshme dhe pajisjeve. Të gjithë produktet e lizingut u janë ofruar segmenteve të biznesit si korporatat dhe bizneset e mesme, ndërkohë që individët e përdorin kryesisht për makina personale. Kontratat e qirasë financiare të reja janë bërë 50 përqind me klientët korporatë, 19 përqind me biznesin e mesëm, 17 përqind me biznesin e vogël dhe pjesa tjetër 14 përqind me klientët individë.

Qëllimi ynë ka qenë kryesisht në forcimin e bashkëpunimit afatgjatë me klientët e Grupit Raiffeisen, duke ofruar mbështetje të frytshme për nevojat e tyre në biznes. Gjithashtu, për të qenë më pranë, Raiffeisen Leasing, i ka kushtuar kujdes të veçantë forcimit dhe vendosjes së bashkëpunimit strategjik me rrjetin e koncensionarëve të shitjeve të makinave që operojnë në Shqipëri. Viti 2015 ka qenë një vit me sfida për tregun shqiptar të automjeteve, ku shitja e makinave të reja ishte pak me shumë se 2,000 njësi. Kriza ekonomike e vendeve fqinjë dhe legjislacioni shqiptar, ka favorizuar importin e makinave të përdorura, gjë që është reflektuar dhe në ecurinë e tregut të makinave të reja.

Raiffeisen Leasing, ju ofron klientëve të tij produkte dhe shërbime me cilësi superiore, si dhe informacion të plotë lidhur me strukturën dhe thjeshtësinë e të gjitha veprimeve të qirasë financiare. Pjesë e aktivitetit të kompanisë është edhe rimarketimi e rishitja e mjeteve. Përsa i përket rishitjes është implementuar procedura që e kanë pozicionuar si ekspert për vendosjen e standardeve në treg. Gjithsesi kompania ka përdorur njohuritë dhe eksperiencën e Raiffeisen Leasing International si dhe të kompanive të tjera të lizingut që operojnë në rajon lidhur me produktet dhe shërbimet e qirasë financiare, si dhe në fushën e marketingut. Për më tepër, kompania ka akses të plotë në rrjetin e madh të furnitorëve ndërkombëtarë të makinave me tonazh të rëndë, makinerive dhe pajisjeve, me të cilët Grupi Raiffeisen ka lidhje të qëndrueshme, në dobi të klientëve ekzistues dhe potencialë të kompanisë për realizimin e planeve të tyre investuese.

Deri në fund të vitit 2015, Raiffeisen Leasing ka patur 18 punonjës, që ju ofrojnë klientëve shërbime të shpejta dhe të përshtashme për nevojat e tyre. Raiffeisen Leasing publikon një gamë të gjerë materialeesh si të printuar ashtu edhe në faqen e internetit www.raiffeisen-leasing.al. Gjatë vitit 2015 Raiffeisen Leasing Sh.a ka ndërmarrë fushata marketingu, kryesisht të bazuar dhe të koordinuar me politikën dhe aktivitetet e marketingut të koncesionerëve vendas si partnerët tanë kryesorë në biznes. Manaxhimi dëshiron të përfitojë nga kjo mundësi për të falenderuar klientët dhe partnerët tanë të biznesit për bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë 2015 dhe sidomos për besimin që ata na kanë dhënë. Gjithashtu jemi shumë mirënjohës ndaj punonjësve tanë për përkushtimin dhe përpjekjet, duke shprehur bindjen tonë që ekipi i Raiffeisen Leasing do të bëjë më mirë gjatë vitit 2016.

Raiffeisen Leasing Sh.a është krijuar me qëllim shtimin dhe promovimin e veprimtarisë së qirasë financiare në Shqipëri, dhe në të njëjtën kohë rritjen e gamës së shërbimeve të ofruara nga grupi i bankës Raiffeisen në këtë treg. Raiffeisen Leasing Sh.a, themeluar në Prill të vitit 2006, është regjistruar në Regjistrin Tregtar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë numër 35733, datë 15.05.2006, me aksionerë Raiffeisen Bank Sh.a me 75 përqind të aksioneve dhe Raiffeisen Leasing International GmbH me 25 përqind të aksioneve.

Perspektivat për vitin 2016

Në sajë të standardeve të larta profesionale dhe ekspertizës së grupit, që janë shumë të forta edhe në kohë të vështira, Raiffeisen Leasing sh.a do jetë në pozita që të mbështesë në mënyrë aktive bizneset në planet e tyre të investimeve edhe gjatë 2016, duke ofruar financimin e mjeteve të lëvizshme dhe pajisjeve. Ne do të jemi tërësisht të përkushtuar në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit afatgjatë me klientët dhe koncesionarët tanë dhe do të vazhdojmë në menyrë aktive t'ju përgjigjemi nevojave të tyre me gamën e produkteve dhe shërbimeve tona.

Duke patur parasysh ndryshimet e mjedisit të biznesit, objektivat tona kryesore do të jenë rritja e biznesit, përmirësimi i shitjeve të kryqëzura me të gjithë segmentet e bankës, përmirësimi i vazhdueshëm i produkteve ekzistuese dhe zhvillimin e të rejtave, manaxhim risku i përshtatshëm, reduktimi i kostove dhe përmirësim i efikasitetit. Ne jemi tërësisht të dedikuar për të mbajtur qëndrueshmërinë e portofolit aktual duke aplikuar parimin e cilësisë në vend të sasisë dhe politikë risku të fortë.

Eksperiencia jonë dhe mbështetja e grupit Raiffeisen, baza e fortë e kapitalit dhe cilësia e portofolit përfaqësojnë garanci që ne do të mbetemi një partner i sigurt dhe i përgjegjshëm për klientët dhe koncesionarët në periudhën në vazhdim.

BERATI

Berat/ Antipatrea në kufijtë e legjendës dhe të historisë, është një arkiv i gurtë që ofron varietete stileshe dhe kontributesh të epokave të ndryshme: ilire, romako-bizantine, shqiptare e turke.





Raiffeisen INVEST Sh.a

Rreth Raiffeisen INVEST Sh.a

Gjatë 2015-ës Raiffeisen INVEST Sh.a vazhdoi të ishte e vetmja shoqëri administruese e licencuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare për administrimin në të njëjtën kohë edhe të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive (fonde investimi) edhe të Fondeve të Pensionit Vullnetar. Në vitin e katërt të aktivitetit, asetet nën administrim njohën një rritje prej 7.4 përqind duke tejkaluar vlerën prej 490 milionë Euro, ndërsa numri i atyre që i besuan fondeve ishte më shumë se 32,000 për fondet e investimit dhe 2,583 për fondin e pensionit.

Në një mjedis bankar me norma të ulëta interesi, investitorët vendas vazhduan të tregojnë interes, kryesisht për fondet e investimit. Këto të fundit i ofrojnë publikut mundësi për të investuar kursimet e tyre në Lekë dhe në Euro në mënyrë fitimprurëse, dhe njëkohësisht mundësi për diversifikim të portofolit financiar jashtë spektrit të produkteve bankare. Po kaq i rëndësishëm ka qenë edhe roli i Fondit të Pensionit, si një mekanizëm efikas për të suplementuar të ardhurat e pensionit duke rritur kursimet gjatë viteve të kontributit. Disa nga avantazhet e fondeve krahasuar me produktet e tjera financiare janë procesi i investimit i thjeshtë dhe komod, si dhe likuiditeti dhe kthimi nga investimi.

Gjatë vitit 2015, Raiffeisen INVEST siguroi një performancë të lartë për të gjithë fondet nën administrim, duke gjeneruar një kthim neto më të lartë se normat e interesit të depozitave 12 mujore të ofruara nga bankat e nivelit të dytë (si në Lekë ashtu edhe në Euro). Mbi të gjitha, kjo u arrit me shumë pak luhatshmëri të çmimeve duke reflektuar qasjen e kujdesshme të shoqërisë administruese në lidhje me politikat e investimit dhe menaxhimit të riskut.

Performanca e Fondeve

Gjatë vitit 2015, fondet nën administrim të Raiffeisen Invest gjeneruan një kthim neto nga investimi (pas zbritjes së tarifës së administrimit) si më poshtë:

- Fondi vullnetar i Pensionit: 7.35 përqind,
- Fondi i investimit Raiffeisen Prestigj: 6.80 përqind
- Fondi i investimit Raiffeisen Invest Euro: 2.20 përqind

Politika e investimit, e ndjekur gjatë vitit 2015 vuri në fokus kombinimin e një menaxhimi të kujdesshëm të likuiditetit dhe shpërndarjen efektive të aseteve duke rezultuar në një kthim të kënaqshëm për investitorët e Fondeve. Portofolet e investimeve evolucionuan në përputhje me këtë objektiv, si dhe në përputhje me zhvillimet e tregut, bazuar në një përzgjedhje të kujdesshme të instrumenteve financiare. Në varësi të fondit, asetet mund të investohen në instrumente të ndryshme financiare në Lekë dhe në Euro, në tregun shqiptar dhe/ose tregjet ndërkombëtare.

Përgjegjësia sociale

Përveçse një viti të suksesshëm për sa i përket rritjes së aseteve nën administrim dhe numrit të investitorëve, Raiffeisen INVEST në bashkëpunim të ngushtë me Raiffeisen Bank dha një kontribut të rëndësishëm për shoqërinë dhe ekonominë shqiptare nëpërmjet programit të saj të sponsorizimeve. Ky program konstistoi në donacione të konsiderueshme për shoqata bamirësie, institucione të ndryshme jo-fitimprurëse si dhe projekte që kanë për qëllim përmirësimin e jetës ekonomiko-sociale të qytetarëve shqiptarë.

Pritshmëritë për vitin 2016

Viti 2016 mund të jetë sërisht një vit sfide për ekonominë shqiptare dhe tregun financiar në tërësi. Niveli i ulët i kreditimit pavarësisht lehtësisë së politikës monetare dhe tkurrja e konsumit mund të shtrihen edhe gjatë 2016-ës dhe ekonomia e vendit mund të vazhdojë të përballet me rreziqe të jashtme, veçanërisht nga performanca e dobët e ekonomive të tjera evropiane.

Raiffeisen INVEST do të vazhdojë të rrisë asetet nën administrim, duke pasur si qëllim përfundimtar përmirësimin e performancës financiare të shoqërisë dhe investitorëve të saj. Ruajtja e performancës së fondeve aktuale dhe shërbimi cilësor për investitorët do të jenë në fokus të biznesit tonë. Por, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edukimit të publikut mbi tregjet financiare, zhvillimit të tregut të kapitalit në Shqipëri si dhe zgjerimit të tregut të pensioneve private, tashmë i mbështetur nga lehtësirat e duhura fiskale.

** Misioni i Raiffeisen Invest është të jetë lider në tregun shqiptar, duke i ofruar klientëve një shërbim të shkëlqyer dhe manaxhim cilësor të aseteve të tyre, si dhe duke i garantuar për integritet, profesionalizëm dhe transparencë gjatë të gjithë etapave të procesit të investimit.*

KUKËSI

Kukës

Motoja e qytetit është "Qyteti i mikpritjes dhe bujarisë". Kukësi është i pozicionuar në verilindje të Shqipërisë, në kufi me Kosovën. Kukësi është i famshëm për rolin e tij gjatë luftës së Kosovës, duke strehuar 450,000 refugjatë. Për këtë, në vitin 2000, Kukësi është qyteti i parë në botë i kandiduar për çmimin Nobel për Paqe.





Një vështrim mbi Raiffeisen Bank International

Raiffeisen Bank International AG përfshin Evropën Qëndrore dhe Lindore (duke përfshirë Austrinë), si tregun e saj amëtar. Për gati 25 vjet, RBI ka funksionuar në rajonin e Evropës Qëndrore dhe Lindore (CEE), ku sot ajo mban një rrjet të ndërthurur ngushtësisht të bankave ndihmëse, të kompanive të lisingut dhe të ofruesve të shumtë të shërbimit financiar të specializuar. Si një bankë universale, RBI renditet ndër pesë bankat kryesore në disa shtete. Ky rol mbështetet nga brandi Raiffeisen, i cili është një prej brandeve më të njohura gjerësisht në rajon. RBI e ka pozicionuar veten në EQL si një grup bankar plotësisht i integruar ndaj konsumatorëve individë dhe korporatave, me një ofertë të gjerë produktesh. Në fund të vitit 2015, rreth 84,000 punonjës të RBI-së kanë shërbyer rreth 14.9 milion klientë në rreth 2,700 njësi të biznesit në Evropën Qëndrore dhe Lindore. Në Austri, RBI është një nga bankat kryesore të korporatave dhe të investimeve. Ajo u shërben kryesisht klientëve austriakë, por edhe atyre ndërkombëtarë, si dhe klientëve kryesorë shumëkombësh që veprojnë në EQL. Numri total i personelit të punësuar nga RBI është rreth 51,000 vetë dhe asetit total i saj ka një vlerë prej rreth 114 miliard Euro.

RZB u themelua në vitin 1927 si "Genossenschaftliche Zentralbank". RZB themeloi bankën e parë në varësi të saj në EQL që në vitin 1987. Që atëherë, janë krijuar edhe shumë degë të tjera. Nga viti 2000 e këtej, zgjerimi i Raiffeisen-it në shtetet e EQL-së është arritur me blerjen e bankave ekzistuese. Si rrjedhojë ato janë shkruirë në një kompani aksionere të cilat operojnë nën emrin e Raiffeisen International që nga viti 2003. Në Prill të vitit 2005 Raiffeisen International u listua në listat e bursës Vienna Stock Exchange në mënyrë që të mund të financonte zgjerimin e saj në të ardhmen në mënyrë sa më efektive. RBI-ja e sotme u krijua në vitin 2010 përmes bashkimit të Raiffeisen International me fushat kryesore të biznesit të RZB. Në fund të vitit 2015, RZB – e cila funksionon si institucioni qendror i Austrian Raiffeisen Banking Group – zotëron afërsisht 60.7 përqind të aksioneve të RBI-së, me pjesën e mbetur të aksioneve në qarkullim të lirë.

Rrjeti i Raiffeisen Bank SHA

Distrikti Tirana 1

"Rruga e Kavajës" Tiranë

Tel: ++355 4 2253 644/6;
 ++355 4 2233 396;
 ++355 4 2224 540
 Fax: ++355 4 2230 013;
 ++355 4 2247 912

Distrikti Tirana 2

Kompleksi "Gintash" Laprakë, Tiranë

Tel: ++355 4 2357828

Distrikti Perëndimor

L3, Rruga Hamdi Troplini,
 pranë Bashkisë Durrës

Tel: ++355 52 254 95;
 ++355 52 25 027

Distrikti Jugor

L. "28 Nëntori", Berat

Tel: ++355 32 32628

"Ismail Qemali" Boulevard, Vlorë

Tel: ++355 33 227 381

Distrikti Jug perëndimor

L. "Kastrioti", Rr. "Brigada e 11 Sultumese", Fier

Tel: ++355 34 22231;
 ++355 34 22282;
 ++355 34 22502

Distrikti Verior

Sheshi Demokracia,
 Hotel Rozafa, Shkodër

Tel: ++355 22 43171;
 ++355 22 43764

L. 5, Kukës

Tel: ++355 24 22279

Distrikti Elbasan

Lagja "Qemal Stafa",
 Rruga 11 Nentori, Elbasan

Tel: ++355 54 42260

Distrikti Jug-Lindor

Shëtitore "Fan Noli", Sky Center, Korçë

Tel: ++355 82 43179
 Fax: ++355 82 45870

Për më tepër informacion ju lutem vizitoni faqen tonë të internetit: www.raiffeisen.al

Adresa dhe Kontakte

Raiffeisen Bank International AG

Austri

Am Stadtpark 9
1030 Vienna
Tel: +43-1-71 707-0
Fax: +43-1-71 707-1715
www.rbinternational.com
ir@rbinternational.com
communications@rbinternational.com

Erjeti Bankar

Shqipëri

Raiffeisen Bank Sh.a.
"European Trade Center"
Bulevardi "Bajram Curri"
Tiranë
Tel: ++355-4-23 8 1000
Fax: ++355-4-22 755 99
SWIFT/BIC: SGSBALTX
www.raiffeisen.al

Bjellorusi

Priorbank JSC
V. Khoruzhey Str. 31-A
220002 Minsk
Tel: +375-17-28 9-9090
Fax: +375-17-28 9-9191
SWIFT/BIC: PJCBY2X
www.priorbank.by

Bosnje dhe Hercegovinë

Raiffeisen Bank d.d.
Bosna i Hercegovina
Zmajca od Bosne bb
71000 Sarajevo
Tel: +387-33-287 100
Fax: +387-33-21 385 1
SWIFT/BIC: RZBABA2S
www.raiffeisenbank.ba

Bullgari

Raiffeisenbank (Bulgaria) EAD
Nikola I. Vapzarov Blvd.
Business Center EXPO 200 PHAZE
III, floor 5
1407 Sofia
Tel: +359-2-91 985 101
Fax: +359-2-94 345 28
SWIFT/BIC: RZBBBGSF
www.rbb.bg

Kroaci

Raiffeisenbank Austria d.d.
Petrinjska 59
10000 Zagreb
Tel: +385-1-45 664 66
Fax: +385-1-48 116 24
SWIFT/BIC: RZBHHR2X
www.rba.hr

Republika Çeke

Raiffeisenbank a.s.
Hvezdova 1716/2b
14078 Prague 4
Tel: + 420-234-405-222
Fax: +420-234-402-111
SWIFT/BIC: RZBCCZPP
www.rb.cz

Hungari

Raiffeisen Bank Zrt.
Akadémia utca 6
1054 Budapest
Tel: +36-1-48 444-00
Fax: +36-1-48 444-44
SWIFT/BIC: UBRTHUHB
www.raiffeisen.hu

Kosovë

Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.
Rruga UÇK, No. 51
10000 Pristina
Tel: +381-38-22 222 2
Fax: +381-38-20 301 130
SWIFT/BIC: RBKOKKPR
www.raiffeisen-kosovo.com

Poloni

Raiffeisen Bank Polska S.A.
Ul. Piękną 20
00-549 Warsaw
Tel: +48-22-58 5-2000
Fax: +48-22-58 5-2585
SWIFT/BIC: RCBWPLPW
www.raiffeisen.pl

Rumani

Raiffeisen Bank S.A.
246 C Calea Floreasca
014476 Bucharest
Tel: +40-21-30 610 00
Fax: +40-21-23 007 00
SWIFT/BIC: RZBRROBU
www.raiffeisen.ro

Rusi

ZAO Raiffeisenbank
Smolenskaya-Sennaya 28
119002 Moscow
Tel: +7-495-72 1-9900
Fax: +7-495-72 1-9901
SWIFT/BIC: RZBMRUMM
www.raiffeisen.ru

Serbi

Raiffeisen banka a.d.
Djordja Stanojevic
11070 Novi Beograd
Tel: +381-11-32 021 00
Fax: +381-11-22 070 80
SWIFT/BIC: RZBSRSBG
www.raiffeisenbank.rs

Sillovakia

Tatra banka, a.s.
Hodžovo námestie 3
P.O. Box 42
85005 Bratislava 55
Tel: +421-2-59 19-1111
Fax: +421-2-59 19-1110
SWIFT/BIC: TATRKBX
www.tatrabanka.sk

Siloveni

Raiffeisen Banka d.d.
Zagrebška cesta 76
2000 Maribor
Tel: +386-2-22 931 00
Fax: +386-2-30 344 2
SWIFT/BIC: KREKSI22
www.raiffeisen.si

Ukrainë

Raiffeisen Bank Aval JSC
9, Vul Leskova
01011 Kiev
Tel: +38-044-49 088 88,
Fax: +38-044-295-32 31
SWIFT/BIC: AVALUAUK
www.aval.ua

Kompani Lizingu

Austri

Raiffeisen-Leasing
International GmbH
Am Stadtpark 3
1030 Vienna
Tel: +43-1-71 707-2071
Fax: +43-1-71 707-76 2966
www.rli.co.at

Shqipëri

Raiffeisen Leasing Sh.a.
 "European Trade Center"
 Bulevardi "Bajram Curri"
 Tirana
 Tel: ++355-4-22 749 20
 Fax: ++355-4-22 325 24
 www.raiffeisen-leasing.al

Bjellorusi

"Raiffeisen-Leasing" JLLC
 V. Khoruzhey 31-A
 220002 Minsk
 Tel: +375-17-28 9-9394
 Fax: +375-17-28 9-9974
 www.rl.by

Bosnje dhe Hercegovinë

Raiffeisen Leasing d.o.o. Sarajevo
 Zmaja od Bosne bb.
 71000 Sarajevo
 Tel: +387-33-254 354
 Fax: +387-33-212 273
 www.rlbh.ba

Bullgari

Raiffeisen Leasing Bulgaria OOD
 32A Cherni Vrah Blvd. Fl.6
 1407 Sofia
 Tel: +359-2-49 191 91
 Fax: +359-2-97 420 57
 www.rlbgbg

Kroaci

Raiffeisen Leasing d.o.o.
 Radnicka cesta 43
 10000 Zagreb
 Tel: +385-1-65 9-5000
 Fax: +385-1-65 9-5050
 www.rl-hr.hr

Republika Çeke

Raiffeisen-Leasing s.r.o.
 Hvězdova 1716/2b
 14078 Prague 4
 Tel: +420-221-511-611
 Fax: +420-221-511-666
 www.rl.cz

Hungari

Raiffeisen Lízing Zrt.
 Vérmező út. 4
 1012 Budapest
 Tel: +36-1-477 8709
 Fax: +36-1-477 8702
 www.raiffeisenlizing.hu

Kazakistan

Raiffeisen Leasing
 Kazakhstan LLP
 Shevchenko Str. 146, No. 12
 050008 Almaty
 Tel: +7-727-378 54 30
 Fax: +7-727-378 54 31
 www.rlkz.at

Kosovë

Raiffeisen Leasing Kosovo
 Gazmend Zajmi n.n., Sunny Hill
 10000 Pristina
 Tel: +381-38-22 222 2
 Fax: +381-38-20 301 103
 www.raiffeisenleasing-kosovo.com

Moldavi

I.C.S. Raiffeisen Leasing S.R.L.
 Alexandru cel Bun 51
 2012 Chişinău
 Tel: +373-22-27 931 3
 Fax: +373-22-22 838 1
 www.raiffeisen-leasing.md

Poloni

Raiffeisen-Leasing Polska S.A.
 Ul. Prosta 51
 00-838 Warsaw
 Tel: +48-22-32 636-00
 Fax: +48-22-32 636-01
 www.rl.com.pl

Rumani

Raiffeisen Leasing IFN S.A.
 Calea Floreasca 246 D
 014476 Bucharest
 Tel: +40-21-36 532 96
 Fax: +40-37-28 799 88
 www.raiffeisen-leasing.ro

Rusi

OOO Raiffeisen-Leasing
 Smolenskaya-Sennaya 28
 119121 Moscow
 Tel: +7-495-72 1-9980
 Fax: +7-495-72 1-9901
 www.raiffeisen-leasing.ru

Serbi

Raiffeisen Leasing d.o.o.
 Djordja Stanojevic 16
 11070 Novi Beograd
 Tel: +381-11-220 7400
 Fax: +381-11-228 9007
 www.raiffeisen-leasing.rs

Sillovakia

Tatra-Leasing s.r.o.
 Černyševského 50
 85101 Bratislava
 Tel: +421-2-59 19-3168
 Fax: +421-2-59 19-3048
 www.tatraleasing.sk

Sloveni

Raiffeisen Leasing d.o.o.
 Letališka cesta 29a
 SI-1000 Ljubljana
 Tel: +386-1-241-6250
 Fax: +386-1-241-6268
 www.rl-sl.si

Ukrainë

LLC Raiffeisen Leasing Aval
 9, Moskovskiy Av.
 Build. 5 Office 101
 04073 Kiev
 Tel: +38-044-59 024 90
 Fax: + 38-044-20 004 08
 www.rla.com.ua

Zyrat e përfaqësimit dhe degët në Evropë

Francë

RBI Representative Office Paris
 9-11 Avenue Franklin D. Roosevelt
 75008 Paris
 Tel: +33-1-45 612 700
 Fax: +33-1-45 611 606

Gjermani

RBI Frankfurt Branch
 Wiesenhüttenplatz 26
 60329 Frankfurt
 Tel: +49-69-29 921 924
 Fax: +49-69-29 921 9-22

Suedi

RBI Representative Office
 Nordic Countries
 Drottninggatan 89, 14th floor
 11360 Stockholm
 Tel: +46-8-440 5086
 Fax: +46-8-440 5089

Mbretëria e Bashkuar
 RBI London Branch
 Leaf C 9th Floor, Tower 42
 25 Old Broad Street
 London EC2N 1HQ
 Tel: +44-20-79 33-8000
 Fax: +44-20-79 33-8099

Zyrat e përfaqësimit dhe degët në Azi and Amerikë

Kina
 Dega RBI në Pekin
 Beijing International Club Suite 200
 2nd floor
 Jianguomenwai Dajie 21
 100020 Beijing
 Tel: +86-10-65 32-3388
 Fax: +86-10-65 32-5926

Dega e RBI në Hong Kong
 Unit 2102, 21st Floor,
 Tower One, Lippo Centre
 89 Queensway, Hong Kong
 Tel: +85-2-27 30-2112
 Fax: +85-2-27 30-6028

Zyra përfaqësuese e RBI në Zhuhai
 Room 2404, Yue Cai Building
 No. 188, Jingshan Road, Jida,
 Zhuhai, Guangdong Province
 519015, P.R. China
 Tel: +86-756-32 3-3500
 Fax: +86-756-32 3-3321

Indi

Zyra përfaqësuese e RBI në Mumbai
501, Kamla Hub, Gulmohar Road,
Juhu
Mumbai – 400049
Tel: +91-22-26 230 657
Fax: +91-22-26 244 529

Korea

Zyra përfaqësuese e RBI në Kore
1809 Le Meilleur Jongno Town
24 Jongno 1-ga
Seoul 110-888
Republic of Korea
Tel: +82-2-72 5-7951
Fax: +82-2-72 5-7988

Singapor

Dega e RBI në Singapor
One Raffles Quay
#38-01 North Tower
Singapore 048583
Phone: +65-63 05-6000
Fax: +65-63 05-6001

SHBA

RB International Finance (USA) LLC
1133 Avenue of the Americas,
16th Floor
10036 New York
Tel: +01-212-84 541 00
Fax: +01-212-94 420 93

Zyra përfaqësuese e RZB Austri në

Nju Jork

1133 Avenue of the Americas,
16th Floor
10036 New York
Tel: +01-212-59 3-7593
Fax: +01-212-59 3-9870

Vietnam

Zyra përfaqësuese e RBI në
Ho-Chi-Minh-City



SHKODRA

Shkodra/ Scutari ka rreth 90 monumente kulture dhe është shpirti i Shqipërisë. Lista e objekteve turistike dhe kulturore për t'u vizituar është e pafundme.

